

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5542
E enjte, 2 gusht 2018
çmimi 0.40 €

MPB-ja merr masa serioze për parandalimin e aksidenteve në trafik

Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka bërë me dije të mërkurën se ministria që drejton dhe Policia e Kosovës kanë marrë masa serioze shtesë me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë në trafik dhe parandalimin e aksidenteve | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

DEMAÇI DHE RUGOVA, HISTORIA E PARRËFYER E NJË MËRIE POLITIKE F.11



Bedri ISLAMI

EPOKA DEMAÇIANE F.3



Izmi ZEKA

THAÇI TAKON DACIN, FLASIN PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI F.3

EKONOMI

DOGANA KONFISKON MBI 50 APARATE ILEGALE PËR LOJËRA FATI F.9

KRU 'PRISHTINA' ZGJATË ORARIN E PUNËS PËR T'U OFRUAR LEHTËSIRA BASHKATDHETARËVE F.8

KULTURË

BISEDË ME SPECIALISTIN E RADIOLOGJISË DIAGNOSTIKE, SAMI RUSTEMIN F.10

SPORT

DRITA BESON FUQISHËM NË KUALIFIKIM F.14

'EPOKA E RE' SYNON MBROJTJEN E TITULLIT F.14

FLET PËR "EPOKËN E RE", BURIM RAMADANI

Nga tranzicioni i FSK-së përfiton rajoni

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Burim Ramadani, e ka quajtur sfidues procesin e tranzicionit të FSK-së nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese. Megjithatë, ai ka bërë me dije se Kosova nuk ka hequr dorë nga angazhimi i vazhdueshëm për këtë proces me anë të ndryshimeve kushtetuese. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ramadani ka thënë se kurdo që të jetë e mundur, ndryshimet kushtetuese do të realizohen. Ai ka deklaruar se Kosova nuk synon ta zëvendësojë praninë e NATO-s dhe të KFOR-it, si dhe nuk synon ta realizojë tranzicionin e FSK-së kundër ndonjë shteti tjetër në Ballkan. Madje, sipas Ramadani, nga tranzicioni i FSK-së përfiton rajoni. Ai ka theksuar se kompletimi i sektorit të sigurisë e aftëson Kosovën të kthehet në kontribuues të veçantë në sigurinë rajonale dhe më gjerë



Haradinaj: Nuk do të ketë ndryshim të kufijve

FAQE 7



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përjashtuar çdo mundësi të ndryshimit të kufijve në fazën finale të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pas vizitës që i ka bërë kampit amerikan në "Bondsteel", kreu i ekzekutivit ka theksuar se idetë për ndarje janë vetëm spekulime. Edhe presidenti Hashim Thaçi ka vlerësuar se pretendimi i Serbisë për ndarje të Kosovës gjithmonë do të jetë i papranueshëm

Ministri Hamza: Kosova ka stabilitet makrofikskal

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka bërë me dije të mërkurën se ministria që drejton, së bashku me agjencitë vartëse - Doganën dhe ATK-në - kanë kontribuar me mbi 83 për qind në totalin e pranimeve të periudhës gjashtëmujore ose rreth 90 për qind të të hyrave buxhetore | FAQE 9



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Britania heq nga rendi i ditës raportin e UNMIK-ut për Kosovën

Nju Jork, 1 GUSHT - Britania e Madhe, e cila nga e mërkura ka marrë kryesimin e Presidencës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ka hequr nga agjenda raportimin 3 mujorësh për gjendjen në Kosovë.

Këtë e ka bërë të ditur konsulja e Kosovës në Nju Jork, Teuta Sahatqija përmes një postimi në Facebook, e cila edhe e ka falënderuar ambasadorin britanik në OKB, Karen Pierce.

"Agjenda e muajit gusht e Këshillit të Sigurimit nën udhëheqjen e Britanisë. Raportimi i UNMIK-ut është hequr nga agjenda me ç'rast është thyer rregulli i raportimit të rregullt 3-mujor", ka shkruar

Sahatqija. Ajo ka falënderuar ambasadorin britanik në OKB, Karen Pierce, dhe gjithë diplomacinë britanike së bashku me misionet mike të SHBA-së, Francës dhe të tjerët.



ShBA-ja mbështet referendumin për emrin e ri të Maqedonisë

Vizita e zyrtarit të lartë të Departamentit Amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, në Shkup, ka për qëllim mbështetjen e ShBA-së për arritjen e Marrëveshjes së Prespës me Greqinë si dhe për progresin e mëtejshëm të vendit drejt anëtarësimit në NATO dhe BE



SHKUP, 1 GUSHT - Faktimi i datës për mbajtjen e referendimit lidhur me Marrëveshjen për emrin me Greqinë ka rritur angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare për përfundimin me sukses të zbatimit të saj, që vlerësohet si një nga marrëveshjet më të rëndësishme që ka arritur Maqedonia me fqinjët që nga pavarësia e saj. Në këtë kuadër në Shkup po qëndron zëvendës-ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit për Evropë dhe Euro-Azi, Matthew Palmer, i cili do të realizojë takime me drejtuesit më të lartë të shtetit.

Diplomati amerikan fillimisht është takuar me presidentin Gjorge Ivanov, ndërsa më vonë

edhe me kryeministrin Zoran Zaev dhe me zyrtarë të tjerë. Sipas një njoftimi të Ambasadës Amerikane në Shkup, vizita e zyrtarit të lartë të Departamentit Amerikan të Shtetit ka për qëllim "mbështetjen e ShBA-së për arritjen e Marrëveshjes së Prespës me Greqinë, si dhe për progresin e mëtejshëm të vendit drejt anëtarësimit në NATO dhe BE".

Mbështetja amerikane për procesin e anëtarësimit euroatlantik të Maqedonisë është theksuar në vazhdimësi edhe nga ambasadori amerikan në Shkup, Jess Baily, i cili e ka vlerësuar shumë të rëndësishme mbështetjen e këtij procesi nga

të gjitha aktorët politikë, por edhe shoqëria në përgjithësi. Ai në një prononcim të mëhershëm ka thënë se dëshiron ta shoh Maqedoninë si anëtare e 30-të e NATO-s. "Unë mendoj se tani qytetarët e këtij vendi, pa dallim se në cilën anë janë, pa dallim se cilit komunitet i përkasin, kanë mundësinë të vendosin për të ardhmen e tyre. Ata mund ta mbështesin marrëveshjen me Greqinë, që hap mundësinë e anëtarësimit në BE dhe çon drejt anëtarësimit në NATO. Janë

vendime të rëndësishme që tani duhet të ndërmerren dhe shprejsoj ta shoh Maqedoninë si Republika e Maqedonisë së Veriut, si anëtarja e 30 e NATO-s. Mendoj se kjo është e rëndësishme për shkak se shumë njerëz në këtë shtet sikur ndiejnë një lloj nervozizmi për të ardhmen. Mendoj se kjo është një mundësi e mirë që të ndaleni dhe ta shikoni historinë në 100 vjetet e fundit, problemet, ndonjëherë dhunën, çështjet me Bullgarinë, Shqipërinë dhe

Greqinë. Tani e keni shansin që fqinjët t'i bëni aleatë", ka deklaruar ambasadori Baily. Mbështetje për zbatimin e Marrëveshjes me Greqinë dhe realizimin me sukses të referendimit ka ardhur edhe nga Bashkimi Evropian. Komisionari për zgjerim dhe fqinjësi të mirë, Johannes Hahn, ka përshëndetur vendimin e Kuvendit që më 30 shtator të mbahet referendum për Marrëveshjen me Greqinë, ndërsa u bëri thirrje të gjithë qytetarëve të Maqedonisë që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre demokratike pasi, sipas tij, bëhet fjalë për vendin dhe të ardhmen e tyre. "BE-ja mbështet këtë marrëveshje dhe zbatimin e saj, si simbol i pajtimit dhe fqinjësisë së mirë në rajon. I ftoj të gjithë. Bëhet fjalë për vendin e tyre dhe për të ardhmen e tyre", ka porositur komisionari Hahn. Referendumi do të mbahet më 30 shtator dhe do të jetë konsultues.

Thaçi takon Dacin, flasin për dialogun Kosovë - Serbi



PRISHTINË, 1 GUSHT - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka takuar të mërkurën kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Nexhat Dacin. Thaçi në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se ka pasur një takim të shkëlqyeshëm me kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Nexhat Daci. "Biseduam për zhvil-

limet aktuale nëpër të cilat po kalon Kosova. Ishte konstatim i përbashkët se në këtë proces të gjithë duhet të marrim përgjegjësi: institucionet, partitë politike parlamentare, opozita, shoqëria civile, Akademia etj. Vetëm të bashkuar mund t'i realizojmë objektivat tona: njohjen reciproke Kosovë - Serbi, ulësen në OKB si dhe anëtarësimin në

të gjitha organizatat e tjera ndërkombëtare. Pretendimi i Serbisë për ndarje të Kosovës gjithmonë do të jetë i papranueshëm, por në kuadër të korrigjimit të kufijve duhet të shtrohet, në procesin e dialogut, tanimë kërkesa dhe e drejta e Luginës së Preshevës për t'iu bashkuar Kosovës", ka shkruar presidenti Thaçi.

ShBA-ja do të dërgojë mbi 100 ushtarë në Kosovë

Uashington, 1 gusht - Mbi 125 ushtarë të batalionit për sulme helikopterë të Gardës Kombëtare të shtetit amerikan Tenesi vitin e ardhshëm do të dërgohen në Kosovë. Ata do të shërbejnë në Kosovë për 11 muaj dhe do t'i ofrojnë ndihmë KFOR-it në ruajtjen e

paqes. "Ushtria e Shteteve të Bashkuara është e pranishme në Kosovë për më shumë se 20 vjet dhe në vitet e fundit këto forca janë komanduar nga Garda Kombëtare", ka thënë gjenerali Max Hatson, raporton "Fox17". "Stabilizimi i këtij vendi është një

angazhim i ShBA-së dhe NATO-s, prandaj Garda Kombëtare e Tenesisë ka vendosur njësi të shumta dhe personal gjatë viteve të fundit, për të ndihmuar në ruajtjen e paqes", ka thënë tutje gjenerali Hatson. Përveç dërgimit të trupave në

Kosovë, Garda Kombëtare e Tenesisë do të dërgojë trupa edhe në Ukrainë dhe Poloni. Zyrtarët kanë thënë se në këto tri misione do të dërgohen pothuajse 1 200 ushtarë, që është numri më i madh i ushtarëve të dërguar në misione jashtë vendit që prej vitit 2010.



Vazhdon të kundërshtohet fuqishëm ideja për ndarjen e Kosovës

Haradinaj: Nuk do të ketë ndryshim të kufijve

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përjashtuar çdo mundësi të ndryshimit të kufijve në fazën finale të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pas vizitës që i ka bërë kampit amerikan në "Bondsteel", kreu i ekzekutivit ka theksuar se idetë për ndarje janë vetëm spekulime. Edhe presidenti Hashim Thaçi ka vlerësuar se pretendimi i Serbisë për ndarje të Kosovës gjithmonë do të jetë i papranueshëm



**EPOKA
ERE** Muhamet KOCI

PRISHINË, 1 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, edhe një herë ka mohuar mundësinë e ndryshimit të kufjeve në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Gjatë vizitës në kampin "Bondsteel", teksa ka komentuar deklaratat për ndarje të priftit të Manastirit të Deçanit, Sava Janjiq, Haradinaj ka thënë se ato nuk përbëjnë kërcënim. Sipas tij, këto deklaratat janë spekulime, duke shtuar se integriteti territorial i vendit është i pacenueshëm. "Për deklaratat e Savas mendoj se kjo është në kuadër të debateve të bëra për diskutimin rreth kufijve. Unë besoj se nuk ka kërcënim nga ndryshimi i kufijve. Të gjithë qytetarët duhet të ndihen të sigurt dhe të jetojnë të sigurt në Kosovë", ka thënë Haradinaj.

Edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mohuar çdo mundësi të ndarjes së Kosovës. Megjithatë, pas takimit që ka pasur të mërkurën me kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Nexhat Daci, ai

ka përmendur mundësinë e korigjimit të kufirit me Serbinë, duke e përmendur Luginën e Preshevës. "Pretendimi i Serbisë për ndarje të Kosovës gjithmonë do të jetë i

papranueshëm, por në kuadër të korigjimit të kufijve duhet të shtrohet, në procesin e dialogut, tanimë kërkesa dhe e drejta e Luginës së Preshevës për t'iu

Kurzi: Vështirë e mendoj këmbimin e territoreve

Kancelari austriak Sebastian Kurz ka folur rreth dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se kryetarëve të dy vendeve ua ka premtuar përkrahjen e plotë të Austrisë dhe se shpreson për një përparim të shpejtë në këtë proces. Në intervistën për gazetën e Sarajevës "Dnevni avaz", ai është pyetur nëse deri në fund të viti do të arrihet marrëveshja për Kosovën dhe nëse do ta përkrahte Austria këmbimin e territoreve. "Ne përkrahim çdo marrëveshje që rezultat ka bashkëpunimin më të

fuqishëm ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe më shumë stabilitet në rajon. Vetëm se këmbimin e territoreve e kam vështirë ta mendoj, sepse rajonin me siguri nuk do ta bëjë më stabil nëse shumë vite pas luftës përpiqem t'i ndryshojmë kufijtë", ka thënë Kurzi. Ai ka theksuar se Ballkani Perëndimor për Austrinë nuk është vetëm synim i kryesimit të Presidencës së BE-së, porse ai me vite ka qenë pjesë thelbësore e politikës së jashtme austriake dhe evropiane.

bashkuar Kosovës", ka thënë Thaçi.

Ndaj kësaj deklaratë ka reaguar deputeti i Alternativës, Ilir Deda, i cili në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se secili duhet ta ketë të qartë që korigjimi i kufijve është eufemizëm për ndarje të Kosovës dhe asgjë tjetër. "Nuk ka pasur president në Kosovë që me aq (mendje) lehtësi dhe dëshirë i ka kontestuar kufijtë e shtetit të vet, e që me betimin e vet duhet t'i mbrojë. Secili duhet ta ketë të qartë se 'korigjimi i kufijve' është eufemizëm për ndarje të Kosovës dhe asgjë tjetër. Mbyllja e syve para tmerrit që po e pret Kosovën, i bënë të gjithë bashkëpjesëmarrës në shkatërrimin e shtetit tonë - sipas planeve të Millosheviqit të vdekur, që po i përfaqon kryetari i tanishëm i Kosovës", ka shkruar Deda.

Një ditë më parë presidenti Thaçi,

në një konferencë për medie, ka pohuar se nuk do të ketë forcë që do ta detyrojë palën e Kosovës të flasë për ndarjen e Kosovës në kuadër të procesit të dialogut me Serbinë. Sipas tij, nuk do të ketë bosnjëzim të Kosovës, nuk do të ketë Ahtisari+ si dhe nuk do të ketë ndarje të Kosovës. "Si president i vendit edhe një herë i siguroj qytetarët e Kosovës se nuk do të ketë forcë që do ta detyrojë Kosovën të diskutojë, e lëre më të pajtohet me ndarjen e saj. Nuk do të lejojmë as të diskutohet e lëre më që dikush të pajtohet me ndarjen e Kosovës. Janë shqetësues zërat që flasin gjëra të tilla, kur me të vërtetë gjërat e tilla po kalojnë së përfoluri edhe nga njerëzit që kanë legalitet edhe në institucionet e vendit. Nuk do të ketë bosnjëzim të Kosovës, nuk do të ketë ndarje të Kosovës, nuk do të ketë Ahtisaari+", ka deklaruar Thaçi.

Mjekët dhe infermierët marrin pagat e kujdestarive me rritje



PRISHINË, 1 GUSHT (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka treguar se nga data 31 korrik mjekët dhe infermierët në QKUK dhe spitale të përgjithshme i kanë marrë kujdestaritë me rritje. Bëhet fjalë për 45 për qind rritje për kujdestaritë e mjekëve dhe 15 për qind rritje për orët shtesë për infermierë. Kjo rritje ka ardhur pas nënshkrimit të kontratës kolektive që ministri Ismaili e ka bërë me përfaqësuesit e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës. "Urime për të gjithë mjekët dhe infer-

mierët tanë të cilët i kanë marrë pagat e kujdestarive me rritje. Mirëqenia e profesionistëve shëndetësorë nuk do të lihet më anash, por do të jetë në qendër të reformave tona, krahas investimeve në infrastrukturë dhe pajisje mjekësore. Nuk do të ndalemi me kaq në përmirësimin e kushteve për kthimin e dinjitetit për ta. Ne po punojmë edhe në Ligjin për Paga, ku për personelin tonë shëndetësor do të bëhet zgjidhje afatgjatë dhe dinjitoze", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".

Flet për "Epokën e re", Burim Ramadani

Nga tranzicioni i FSK-së



Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Burim Ramadani, e ka quajtur sfidues procesin e tranzicionit të FSK-së nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese. Megjithatë, ai ka bërë me dije se Kosova nuk ka hequr dorë nga angazhimi i vazhdueshëm për këtë proces me anë të ndryshimeve kushtetuese. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ramadani ka thënë se kurdo që të jetë e mundur mundshme ndryshimet kushtetuese do të realizohen. Ai ka deklaruar se Kosova nuk synon ta zëvendësojë praninë e NATO-s dhe të KFOR-it, si dhe nuk synon ta realizojë tranzicionin e FSK-së kundër ndonjë shteti tjetër në Ballkan. Madje, sipas Ramadani, nga tranzicioni i FSK-së përfiton rajoni. Ai ka theksuar se kompletimi i sektorit të sigurisë e aftëson Kosovën të kthehet në kontribuues të veçantë në sigurinë rajonale dhe më gjerë

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 1 GUSHT -

"Epoka e re": Z. Ramadani, si është duke ecur procesi i transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forca të Armatosura? Kryeministri ka paralajmëruar se ky proces do të përmbyllet këtë vit. Sa janë gjasat që kjo të ndodhë, kur kemi parasysh se Lista Serbe e kundërshton transformimin e FSK-së?

Ramadani: Kompletimi i sektorit të sigurisë e aftëson Kosovën të kthehet në kontribuues të veçantë në sigurinë rajonale dhe më gjerë. Në të njëjtën kohë, ofron mundësinë që secili shtet në rajonin tonë të ndërtojë politika të përbashkëta të sigurisë dhe të mbrojtjes përballë kërcënimeve dhe sfidave globale të sigurisë. Qeveria dhe institucionet në tërësi vazhdojnë të punojnë në metodologji gjithëpërfshirëse dhe të detajuar në procesin e tranzi-

cionit. Puna sistemike do të përmbyllet suksesshëm në këtë tranzicion. Komunikimi me të gjithë aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë është duke vazhduar. E kemi krejtësisht të qartë se siguria nacionale e Kosovës është ngushtë e lidhur me partneritetin strategjik me ShBA-në dhe NATO-n, duke synuar kështu thellimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit dhe partneritetit sipas interesit nacional të Kosovës. Sidoqoftë, në këtë moment çështja më e rëndësishme është prezantimi i të mirave që sjellë tranzicioni i FSK-së. Këto janë të mirat e tranzicionit të FSK-së: 1. Sigurohet institucion profesional dhe shumetnik; 2. Shmanget çfarëdo vakuumi i sigurisë në Ballkan, veçanërisht në bashkëpunimin ndërshtetëror për situata emergjence; 3. Ofrohet përfaqësim i të gjitha komuniteteve; 4. Bashkëpunohet ngushtë me KFOR-in dhe NATO-

n; 5. Ofrohet siguria brenda Kosovës, në rajon dhe në botë; 6. KFOR-i dhe NATO-ja vazhdojnë rolin e tyre në Kosovë dhe rajon; 7. Zhvillimi i ushtrisë së vogël, shumetnike dhe profesionale e forcon sigurinë dhe stabilitetin rajonal; 8. Një hap i rëndësishëm drejt integritetit euroatlantik; 9. Anticipojmë se kjo do të jetë një xitje ekonomike, përkatësisht kjo iniciativë krijon 2 500 vende të reja të punës, ndër to një numër i respektuar për komunitetet pakicë; 10. Ndhomon në përfshirjen e mëtejshme të minoriteteve në shoqëri; dhe 11. Siguri për të gjitha komunitetet. Kosova nuk synon ta zëvendësojë praninë e NATO-s dhe KFOR-it. Përkundrazi, ky do të ishte një kontribut shtesë. Kosova nuk synon ta realizojë tranzicionin e FSK-së kundër ndonjë shteti tjetër në Ballkan. Përkundrazi, jetojmë në kohën e koncepteve të 'smart defence' ('mbrojtja e mençur') dhe bashkëpunimi

përfiton rajoni

i rivitalizuar në vitin 2017. Të gjitha këto dokumente strategjike dhe veprime institucionale janë bërë dhe vazhdojnë të jenë në transparencë të plotë me shtetet partnere, me NATO-n dhe me BE-në. Ne kemi planin dhjetëvjeçar për t'i zhvilluar kapacitetet e kufizuara për mbrojtje, sikurse do të jetë FSK-ja pas tranzicionit. Janë tri faza të këtij plani 10-vjeçar të cilat do të implementohen në transparencë të plotë. Për më shumë, tranzicioni i FSK-së është krejtësisht i përbalueshëm për buxhetin e Kosovës. Kosova nuk heq dorë nga angazhimi i vazhdueshëm për ndryshime kushtetuese. Ky është vazhdimisht qëllimi ynë kryesor, sepse e kemi të qartë që me ndryshimet kushtetuese do të jemi në gjendje ta ndryshojmë emrin dhe të maksimalizojmë mbështetjen politike në Kuvend. Në pjesën substanciale ndryshimi i legjislacionit është i lidhur drejtpërdrejt me avancimin e kornizës ligjore dhe kapaciteteve të FSK-së, si dhe avancimin e mandatit aktual. Ne nuk do të dekurajohemi asnjëherë. Kurdo që të jetë e mundshme, ndryshimet kushtetuese do të realizohen. Në të njëjtën kohë, e kemi mjaftueshëm të qartë se kjo është një sfidë.

"Epoka e re": Sa mund të ndikojë në transformimin e FSK-së largimi i pjesëtarëve të FSK-së nga komuniteti serb?

Ramadani: FSK-ja është shtëpi e të gjithëve. Ndikimi nga jashtë që disa pjesëtarë të komunitetit serb ta kërkojnë largimin nga FSK-ja është një fatkeqësi. Ne ndihemi keq për këtë influencim. Kosova dhe partnerët e Kosovës kanë bërë jashtëzakonisht shumë përpjekje që secili qytetar i Kosovës të jetojë i lirë, të marrë lirshëm vendime për jetën e vet, karrierën e vet, perspektivën e vet, qëndrueshmërinë e vet, mirëqenien e vet. Po e përsëris, është një fatkeqësi mënyra e tillë e të menduarit dhe të vepruarit që ndikon tek njerëzit e Kosovës të marrin vendime që lirshëm nuk do t'i merrnin. Sigurisht se kjo temë është diskutuar vazhdimisht dhe ne kemi informuar të gjithë partnerët e Kosovës për këto rrethana. Patjetër se kjo nuk është dhe nuk paraqet pengesë për të ardhmen e FSK-së. Është vetëm pengesë për të ardhmen personale të disa qytetarëve të Kosovës që janë detyruar të marrin vendime në kundërshtim me bindjen e vet dhe me karrierën e vet. Për më shumë, FSK-ja është kredibile, përfaqësuese dhe e gatshme. Do të jetë një kontribut i veçantë për

sigurinë dhe paqen në rajon, ndërsa do të ndihmojë edhe ekonominë e Kosovës. Asgjë nuk ka mbetur anash në këtë proces sistematik. Jam jashtëzakonisht mirënjohës për mbështetjen që marrim vazhdimisht nga partnerët bilateralë. Është e veçantë kur ta shohësh gatishmërinë e partnerëve për ta thëlluar bashkëpunimin bilateral. Kjo është periudhë me fat për vendin tonë në këtë aspekt. Kosova dhe FSK-ja ka miq të vërtetë. Ka mbështetës të jashtëzakonshëm. Kjo është rruga e suksesit tonë të përbashkët.

"Epoka e re": Për këta muaj sa jeni zëvendësministër, çfarë mendimi keni për qeverisjen në vend, partneritetin me partitë e tjera në koalicion?

Ramadani: Një gjë është e qartë: ka ndryshuar qeverisja në Kosovë! Nuk kemi të bëjmë me qeveri që nuk mund t'i zbatojë vendimet e

veta, derisa vendimmarrja është shumë më efektive dhe më transparente. Sidoqoftë, besoj se në secilën rrethanë Qeveria dhe opozita duhet të kenë rrugë dykahëshe në komunikimin mes tyre. Qëndrimet opozitare duhen respektuar. Qëndrimet racionale opozitare duhen pranuar. Në anën tjetër, duke qenë se kanë mbetur shumë çështje në proces e sipër, një varg arritjesh janë bërë dhe nuk besoj se kontestohen. Besoj se edhe opozita është e kënaqur për Ligjin për Prishtinën, si shembull. Apo për mundësimin që komunat të kenë në dispozicion pronat që nuk i kishin. Besoj se janë të gëzuar që gjyqtarët e prokurorët kanë paga të dinjitetshme tash. Besoj se edhe opozita është e kënaqur që gjatë muajve të fundit u plotësuan edhe dy kushtet e mbetura për liberalizimin e vizave. Apo që Kosova do ta arrijë sigurinë energjetike në investimin tashmë të kontraktuar.

Normalisht, ka shumë fusha në të cilat duhet racionalitet dhe përkushtim më i madh i dikastereve qeveritare, sepse problemet mbeten të shumta. Ky është përkushtimi që duhet të ndiqet më tutje.

"Epoka e re": Opozita po kërkon zgjedhje për faktin se po thotë se këto institucione nuk kanë legjitimitet, sepse nuk e keni shumicën në Kuvend. A mund të mbijetojë ky koalicion qeverisës deri në fund të mandatit?

Ramadani: Aspekti i zgjedhjeve është temë për të cilën subjektet politike pajtohen mes vete si për afatet kushtetuese, po ashtu për rrethanat e tjera. Besoj se është detyrë praktike e opozitës të kërkojë zgjedhje të parakohshme, derisa është detyrë e Qeverisë t'i vazhdojë përpjekjet për ta ndryshuar gjendjen në vend. Një opozitë, si kjo e tashmja, nuk e ka të qartë nëse kërkon zgjedhje apo jo? Kjo është përshtypja ime. Do të doja ta shihja opozitën duke bërë punën e vet në mbikëqyrjen më të rreptë të Qeverisë. Sepse, kjo i ndihmon vendit. I ndihmon edhe Qeverisë. Duke njohur shumicën e zyrtarëve të partive opozitare jam i sigurt se mund të bëjnë opozitë reale ndaj Qeverisë. Pse nuk e bëjnë, realisht nuk e kuptoj!

Draftstatuti i Asociacionit përfundon brenda afatit të caktuar nga BE-ja

PRISHTINË, 1 GUSHT - Ekipi menaxhues për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe është takuar sot me shefin e Misionit të OSBE-së, Jan Brathu, dhe përfaqësuesit e këtij misioni në Kosovë të cilët i ka informuar për procesin e hartimit të statutit të Asociacionit.

Anëtarët e këtij ekipi i kanë informuar bashkëbiseduesit se puna në tekstin është në fazën përfundimtare dhe se draftstatuti i Asociacionit do të për-

fundojë brenda afatit të caktuar nga Bashkimi Evropian, përkatësisht deri më 4 gusht. "Ekipi menaxhues është gati që në çdo kohë pas 4 gushtit, me kërkesën e Brukselit, ta paraqesë tekstin në komitetet për zbatimin dhe para pjesëmarrësve të dialogut në nivelin të lartë, siç parashikohet në marrëveshjet e mëhershme në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Anëtarët e ekipit menaxhues shprehin keqardhje sepse në punën e deritan-

ishme nuk ishin në gjendje të takohen në Bruksel me komitetet për zbatim, as të paraqesin punën në tekstin në fazat, siç parashikohet në marrëveshje, ndoshta të marrin disa sugjerime", është thënë në një njoftimin e këtij ekipi. Ekipi menaxhues thekson në kumtesë se do të vazhdojë të punojë në draftstatut, edhe pse është pothuajse i mbaruar, me qëllim të përmirësimit shtesë, deri në prezantimin në Bruksel.



midis të gjitha shteteve në rajon është avancim i përbashkët. Prania e NATO-s dhe KFOR-it në Kosovë është një vlerë e shtuar për sigurinë rajonale tashmë gati 20 vjet. Për më shumë, as dokumentet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nuk e parandalojnë ndërtimin e institucioneve shumetnike dhe profesionale. Përkundrazi, FSK-ja si institucion shumetnik e profesional do të jetë në partneritet të plotë me KFOR-in.

"Epoka e re": Nëse kjo nuk bëhet me ndryshime kushtetuese, a do të mundin institucionet e vendit këtë proces ta bëjnë edhe përmes ligjit?

Ramadani: Asgjë nuk është ad hoc në këtë proces. Kosova ka një plan të qartë dhe të koordinuar. Tranzicioni i FSK-së bazohet në: 1) Kornizën gjithëpërfshirëse kushtetuese që nga 2008-ta; 2) Reformën Strategjike të Sektorit të Sigurisë që nga 2014-ta; 3) Planin e aktiviteteve që nga viti 2014 dhe

Kosova po ndërmer reforma për menaxhimin e migrimin

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 1 GUSHT - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, njëherësh koordinator nacional për migrim, ka mbajtur të mërkurën takimin e Komitetit të Tretë Drejtues të Projektit Rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, lidhur me përkrahjen e mbrojtjes sensitive të menaxhimit të migrimit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqisë. Në këtë takim zëvendësministri Zeka ka thënë se Republika e Kosovës ka bërë progres të theksuar në proceset demokratike dhe konsolidimit të institucioneve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. "Marrëveshja e Stabilizim Asociimit na shërben si udhërrëfyes për reformat që

jemi duke i ndërmarrë si Ministri e Punëve të Brendshme, në veçanti në fushat që ndërlidhen me menaxhim të migrimit dhe menaxhim të kufirit. Andaj reformat legislative dhe të politikave në këto fusha janë bërë në përputhje me standardet evropiane dhe gjithnjë me përkrahjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë dhe evropianë, duke theksuar këtu përkrahjen e vazhduar që kemi nga Bashkimi Evropian", ka thënë Zeka. Gjithashtu, zëvendësministri Zeka ka falënderuar Komisionin Evropian për përkrahjen që ka dhënë dhe vazhdon ta përkrahë Kosovën në shumë aspekte, në veçanti në fushën e migrimit, si dhe partnerët e tjerë evropianë dhe ndërkombëtarë në zbatimin e projekteve dhe ofrimin e ekspertizës për institucionet tona dhe për shtetin tonë.




Në fund të takimit zëvendësministri Zeka ka theksuar se ky takim do të duhej të shfrytëzohej si një platformë e bashkëpunimit dhe planifikimit të përbashkët, në mënyrë që të dalim sa më

shumë punë dhe suksese në zbatim të projektit dhe avancimit të proceseve në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në përputhje me proceset e integritetit të Kosovës dhe fqinjëve

tanë në Bashkimit Evropian. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Zyrës së BE-së në Kosovë, FRONTEx-i, IOM-it, EASO-s UNHCR-se si dhe zyrtarë të lartë të MPB-së.

Gjakova, komuna e parë me kontrata të hapura



GJAKOVË, 1 GUSHT (ER) - Komuna e Gjakovës bëhet komuna e parë me kontrata të hapura dhe të publikuara në faqen zyrtare të komunës. Këtë vendim e ka marrë Zyra e Prokurimit e kësaj komune me aprovimin e kryetarit të komunës Ardian Gjini. Hapja e kontratave është bërë si rezultat i bashkëpunimit të Demokracisë Plus (D+), Komunës së Gjakovës dhe Projektit të USAID për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse, me qëllim të rritjes së transparencës dhe mundësisë së qytetarëve të komunës për të qenë të infor-

muar në lidhje me shpenzimet e komunës.

Për herë të parë kontratat e kësaj komune do të jenë publike si të plota. Deri më tani janë publikuar vetëm informata të kufizuara përmes njoftimeve të ndryshme. Qytetarët, mediet dhe shoqëria civile mund t'u qasen kontratave në uebfaqen e komunës. Kjo ka rëndësi të veçantë pasi të gjitha palët mund të shohin se si komuna ka lidhur kontrata, me çfarë kushte, me cilët operatorë dhe me çmime për njësi veç e veç. Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka thënë se është i

kënaqur që komuna që ai drejton është e para që ndërmer këtë hap dhe se do të vazhdojë me përkushtim për prokurim të hapur. Ndërsa Valmir Ismaili, drejtor ekzekutiv i D+, ka thënë se shembulli i Komunës së Gjakovës duhet të merret edhe nga 37 komunat e tjera dhe nga të gjitha autoritetet kontraktuese publike. Demokracia Plus u bënë thirrje edhe Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ta bëjnë të detyrueshme për të gjitha institucionet publike, publikimin e kontratave në platformën e e-Prokurimit.

Sot përurohet Sheshi 'Adem Jashari'

PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Sheshi "Adem Jashari" në kryeqytet do të përurohet sot (e enjte) në orën 19:00 ka bërë me dije kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, në një konferencë për media. Punimet e këtij sheshi, që kishin filluar në muajin mars të këtij viti, kanë përfunduar nëntë ditë para afatit kohor të paraparë. Ahmeti në këtë konferencë për media, ku ishte i pranishëm edhe dejtari i Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të

Kontratave, Gëzim Mehmeti, kanë folur për të gjitha projektet infrastrukturore që janë realizuar dhe pritet të realizohen gjatë këtij viti. Aty u tha se edhe punimet për stadiumin e qytetit që mban emrin "Fadil Vokrri" tashmë kanë përfunduar. Sipas tyre, prioritet i komunës është rruga A, unaza te Rrethi që është bashkëpunim me Qeverinë dhe BERZh-in, Salla Koncertale, Pallati i Rinisë, Parkingu Nëntokësor te Fakulteti i Filologjisë dhe të tjera projekte.



Hoxhaj: Është koha që UNMIK-u të shkojë

PRISHTINË, 1 GUSHT - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se misionet e Kombeve të Bashkuara

punojnë më së miri kur ato janë të përshtatshme për qëllim. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar se

misioni i UNMIK-ut në Kosovë ka kompletuar mandatin një dekadë më parë. "Që prej atëherë është bërë barrë financiare për Kombet

e Bashkuara. UNMIK-u nuk ka qëllim, nuk ka funksionalitet, detyrë apo synim. Është koha të mbyllet", ka shkruar Hoxhaj.

Haradinaj: Kampi 'Bondsteel', shpresë dhe garantues i paqes në Kosovë

FERIZAJ, 1 GUSHT (ER) - Kampi 'Bondsteel' është shpresë dhe garantues i paqes për të gjithë që jetojnë këtu. Kështu ka thënë të mërkurën kryeministri Ramush Haradinaj gjatë vizitës që i ka bërë kampit ushtarak amerikan "Bondsteel" në Sojevë të Ferizajt. Ai ka thënë se edhe më tutje shpreson në mbështetjen dhe partneritetin strategjik me ShBA-në, veçanërisht ndihmën dhënë FSK-së.

Ndalesën e parë në këtë vizitë kryeministri Haradinaj, i shoqëruar nga komandanti Ducich, e ka zhvilluar në spitalin e kampit, ku ofrohen shërbimet mjekësore dhe ku nga afër ka parë shërbimet mjekësore që ofrohen në këtë repart.

Më pas, kryeministri Haradinaj ka vizituar sektorin e çminimit, ku nga ekspertët ushtarakë amerikanë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës i është shpjeguar puna dhe procesi që zhvillohet në këtë repart, nga i cili që nga paslufta e deri më tani janë çminuar numër i madh zonash të minuara në gjithë Kosovën. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka falënderuar ushtarët amerikanë për kontributin e tyre në forcimin dhe ngritjen e kapaciteteve të pjesëtarëve të FSK-së.

Kryeministri Haradinaj vizitën e

ka vazhduar edhe në pistën e helikopterëve, ku në mënyrë simbolike, në shenjë mirënjohje dhe respekti për vizitën, nga komandanti Ducich i është dorëzuar flamuri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kryeministri Haradinaj, pas pranimit të flamurit, ka thënë se ndihet tepër i nderuar me këtë respekt që po i bëhet nga një shtet mik, siç është ShBA-ja.

Më pas Haradinaj, i shoqëruar nga komandanti Ducich dhe ushtarakë të këtij kampi, të cilët shërbejnë në Kosovë, ka drekuar në mensën ku janë të punësuar një numër i madh punëtorësh kosovarë. Lidhur me këtë, kryeministri Haradinaj ka thënë se kampi "Bondsteel", përveç misionit ushtarak që ka në ofrimin e sigurisë për qytetarët e Kosovës, ka edhe një dimension tjetër më të gjerë, atë social dhe ekonomik, sepse u ka mundësuar qindra familjeve kosovare të ardhura financiare.

Në përmbyllje të vizitës, e para e këtij lloji nga një kryeministër i Republikës së Kosovës, kryeministri Haradinaj, së bashku me komandantin Ducich, u prononcuan para mediave të pranishme.

Kryeministri Haradinaj ka theksuar se Kosova është shtet shumetnik dhe është garantuese



e paqes edhe në regjion. "Sot jam i nderuar të jem me ju dhe ju falënderoj për kohën, si dhe për atë që pashë këtu, sesa shumë është punuar", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se jo vetëm që është kujdesur për nevojat shëndetësore të qytetarëve, por edhe për bashkëpunimin me Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe

mbështetjen e dhënë. "Shpresojmë se edhe më tutje të jemi partnerë me ju dhe ta mbështesni FSK-në", ka thënë ai.

Ndërkaq komandanti i kampit "Bondsteel", kolonel Nick Ducich, pasi ka vlerësuar lartvizitën e kryeministrit Haradinaj në këtë kamp, ka thënë se edhe me tutje do ta vazhdojnë mbështetjen për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

"FSK-ja po e demonstroi çdo ditë e më shumë profesionalizmin e vet, duke qenë në shërbim të qytetarëve të Kosovës", ka deklaruar komandanti Ducich.

Në fund të vizitës së tij kryeministri Haradinaj ia dorëzoi flamurin shtetëror të Kosovës komandantit Ducich si shenjë nderimi dhe respekti institucional për rolin e Kampit "Bondsteel" në Kosovë.

MPB-ja merr masa serioze për parandalimin e aksidenteve në trafik

Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka bërë me dije të mërkurën se ministria që drejton dhe Policia e Kosovës kanë marrë masa serioze shtesë, me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë në trafik dhe parandalimin e aksidenteve

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 1 GUSHT - Kolegji "Tempulli" ka mbajtur të mërkurën tryezën me temë "Analiza e gjendjes të sigurisë në rrugët e Kosovës", ku i pranishëm ishte edhe ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi. Ministri Gashi ka bërë me dije se ministria që drejton dhe Policia e Kosovës kanë marrë masa serioze shtesë me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë në trafik dhe parandalimin e aksidenteve. Ai ka thënë se për këtë çështje është formuar edhe një task forcë. "Duke iu referuar situatës aktuale lidhur me aksidentet në trafik dhe pasojat e tyre, Ministria e Punëve të Brendshme përmes Policisë së Kosovës ka marrë masa serioze shtesë me qëllim të ngritjes së

nivelit të sigurisë, parandalimin e aksidenteve të trafikut dhe zbatimin e ligjshmërisë në funksion të menaxhimit dhe kontrollit të trafikut rrugor. Për këtë qëllim Policia e Kosovës nga data 24 korrik 2018 ka themeluar task forcën për parandalimin e aksidenteve në trafikun rrugor", ka theksuar ministri Gashi.

Ai ka shprehur shqetësimin e tij rreth rritjes së numrit të aksidenteve me fatalitet në trafik. "Si ministër i Punëve të Brendshme dëshiroj ta shpreh shqetësimin tim për gjendjen aktuale të sigurisë në trafikun rrugor, referuar numrit të aksidenteve në trafikun rrugor, përfshirë këtu një numër të konsiderueshëm të aksidenteve me fatalitet", ka deklaruar Gashi. Me këtë rast, ai ka shtuar se me qëllim të parandalimit të aksi-



denteve në trafikun rrugor dhe ngritjes së sigurisë në trafikun rrugor, Policia e Kosovës ka realizuar shumë aktivitete.

Në fund, ministri Gashi ka vlerësuar se problematika e sigurisë në trafik është mjaft komplekse

dhe kërkon trajtim ndërinstitucional. Ai ka deklaruar se MPB-ja do të mbetet e përkushtuar të kontribuojë në rritjen e sigurisë së qytetarëve në trafikun rrugor, duke bashkëpunuar ngushtë me të gjithë partnerët institu-

cionalë kompetentë dhe përgjegjës në këtë fushë. Edhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë tryezë kanë vlerësuar se duhet të dilet me hapa konkretë me qëllim të zvogëlimit të numrit të aksidenteve në trafik.

KRU 'Prishtina' zgjatë orarin e punës për t'u ofruar lehtësira bashkatdhetarëve

PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina", përkatësisht Departamenti për Konsumatorë, ka njoftuar konsumatorët në qytetin e Prishtinës se duke filluar nga dita e mërkurë, 18 korrik 2018 dhe duke vazhduar deri më 1 shtator 2018, do ta zgjasë orarin e punës në pikat e shitjes, arkat për pagesa të shërbimeve edhe për dy orë të tjera. Kështu që, orari i punës nga dita e hënë deri të premtën do të jetë nga ora

08:00-18:00, ndërsa ditën e shtunë do të punohet nga ora 09:00-16:00. "Arsyeja e zgjatjes së orarit të punës në këtë departament është ofrimi i shërbimeve cilësore për bashkatdhetarët tanë derisa janë duke pushuar në Republikën e Kosovës. Diaspora përbën një element shumë të rëndësishëm në Republikën e Kosovës dhe kjo për shumë arsye, ekonomike, sociale dhe kulturore, duke u fokusuar në rolin e saj kontributdhënës që nga vitet e

'60-ta e deri në ditët e sotme të lirisë", thuhet në njoftimin e KRU "Prishtina". Përveç pagesave që mund të bëjnë në pikat e shitjes, atyre u ofrohen edhe shërbime të tjera si, ankesa, kërkesa, lexim të ujëmatësve etj. KRU "Prishtina" ka ftuar secilin konsumator të jetë sa më i rregullt në kryerjen e obligimeve financiare sepse vetëm në këtë mënyrë mund t'u shmangen ndëshkimeve të kompanisë, gjegjësisht shkyçjes nga shërbimet.



AKP-ja e privatizimit shpalli rezultatet e shitjeve përmes likuidimit nr. 39



PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) të mërkurën në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjeve nr. 39 përmes metodës së likuidimit shpalli çmimet më të

larta të ofruara për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje. Për 114 asete sa ishin në shitje përmes kësaj vale të tenderuar gjithsej u pranuan 87 oferta dhe vlera e

tërësishme e ofertave më të larta ishte 1 765 337 euro. Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente, para

përfaqësuesve të mediave, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm, ndërkaq është bërë transmetimi drejtpërdrejt i cere-

monisë përmes faqes zyrtare të internetit të AKP-së, duke mundësuar përcjelljen e ceremonisë edhe për të gjithë qytetarët e interesuar që s'kanë qenë të pranishëm në sallë.

Ministri Hamza: Kosova ka stabilitet makrofiskal

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka bërë me dije të mërkurën se ministria që drejton së bashku me agjencitë vartëse, Doganën dhe ATK-në, kanë kontribuar me mbi 83 për qind në totalin e pranimeve të periudhës gjashtëmujore ose rreth 90 për qind të të hyrave buxhetore

dije se të hyrat tatimore gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2018 në raport me vitin 2017 u rritën nga 663 milionë në 705 milionë euro, rritje kjo për 42.3 milionë euro ose 6.4 për qind krahasuar me periudhën paraprake.

Ministri Hamza ka folur edhe sa i përket shpenzimeve për paga dhe mëditje. Sipas tij, ato shënuan vlerën prej 293.8 milionë eurosh gjatë këtij gjashtëmujori që paraqet rritje prej 19.65 milionë eurosh më shumë krahasuar me gjashtëmujorin e vitit 2017. "Kjo rritje vjen kryesisht si rezultat i rritjes së pagave sipas legjislacionit në fuqi si dhe zbatimit të vendimit për ngritjen e pagave. Shpenzimet në subvencione dhe transferime regjistruan shumën prej 253.6 milionë eurosh, që paraqet një

rritje prej 22.7 milionë eurosh më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Kjo rritje vjen si rezultat i fillimit të implementimit të tri skemave të reja sociale për herë të parë në Kosovë: Pagesa për personat e paafte në vendin e punës, skema për pagesë të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë si dhe pagesa për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës", është shprehur ai, duke shtuar se shpenzimet kapitale arritën vlerën prej 183 milionë eurosh. "Kjo paraqet një rritje prej 23.7 milionë eurosh ose rreth 15 për qind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017, duke arritur kështu normën e ekzekutimit të kënaqshme që është në përputhje me planifikimin tonë", ka deklaruar Hamza.

Sa i përket borxhit shtetëror, ministri Hamza ka bërë me dije ka arritur ta stabilizojë nivelin e rritjes së borxhit publik, e cila në nivel të BPV-së është zvogëluar për 0.4 për qind. Ndërsa për këtë gjashtëmujor janë marrë grante 65.5 milionë euro, ndërsa për tërë mandatin janë marrë grant 94.1 milionë euro. Po ashtu, ministri në këtë konferencë për media ka bërë me dije se më 30. 7. 2018 Republika e Kosovës për herë të parë, në 10-vjetorin e shtetësisë emetoi me sukses të plotë obligacionin dhjetëvjeçar në shumën prej 10 milionë eurosh. "Ky aktivitet tregoi interesim të madh nga publiku, të cilët ofertuan në tregun e lirë, duke ofruar 13.38 milionë euro, ndërsa norma e kuponit (interesi) u përcaktua nga tregu 5.2 për qind", ka thënë Hamza.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 GUSHT - "Ministria e Financave me agjencitë vartëse, Doganën dhe ATK-në, kanë kontribuar me mbi 83 për qind në totalin e pranimeve të periudhës gjashtëmujore ose rreth 90 për qind të të hyrave buxhetore", ka bërë me dije të mërkurën ministri i Financave, Bedri Hamza, në konferencën për media, ku ka prezantuar raportin financiar gjashtëmujor për performancën e të hyrave

dhe shpenzimeve buxhetore. Sipas ministrit Hamza, si rezultat i pranimeve më të mëdha sesa pagesat për periudhën janar-qershor 2018, bilanci i fondeve është rritur për 15.5 milionë euro, përkatësisht tre për qind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë paraprake.

Ai ka thënë se bilanci i fondeve më 30 qershor 2018 rezultoi 373.3 milionë euro.

Ndërkaq sa i përket të hyrave për gjashtëmujorin e parë të vitit, ministri Hamza ka bërë me



Dogana konfiskon mbi 50 aparate ilegale për lojëra fati

PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Në kuadër të parandalimit të veprimtarive ilegale, njësitë e Doganës gjatë javës së fundit kanë organizuar një aksion të gjerë në dy qytete, respektivisht në Vushtrri dhe Mitrovicë. "Gjatë këtij aksioni, duke u bazuar në informatat e siguruarara përmes rrugëve operative, janë identifikuar dhe targetuar mbi 20 lokacione të dyshuara

për aktivitete me lojëra fati ilegale. Njësitë e Doganës kanë ushtruar kontrolle në të gjitha lokacionet, duke përshtatur edhe kohën e kontrolleve me oraret e punës, pasi një pjesë e tyre i mbajnë mbyllur lokalet gjatë ditës. Si rrjedhojë e kontrolleve janë kapur një sasi e konsiderueshme e aparateve për lojëra fati si dhe lojëra të tjera të ndaluara si 'Keno' dhe

'Racing Dogs', është thënë në njoftimin e Doganës. Sipas këtij njoftimi, janë konfiskuar 50 aparate ilegale për lojëra fati. "Dogana do t'i vazhdojë edhe aktivitetet e tjera në kuadër të zbatimit të ligjit, por edhe kërkojmë ndihmën e qytetarëve të ndihmojnë për identifikimin e lokacioneve", është theksuar në njoftimin e Doganës.



Kosova e Maqedonia do ta nënshkruajnë Kalendarin e Përbashkët Kulturor

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 GUSHT - Me ftesë të ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, po qëndron në Kosovë, në vizitën e tij të parë zyrtare, në cilësinë e ministrit, Asaf Ademi, ministër i Kulturës së Republikës së Maqedonisë, i cili ka marrë këtë detyrë para një muaji. Fillimisht ministri Gashi e uroi homologun nga Maqedonia për marrjen e detyrës, duke i dëshiruar mbarëvajtje në punën dhe arritjen e synimeve. Gjatë takimit të dy ministrat kanë diskutuar për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit midis dy ministrive në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore dhe atë të

së drejtës së autorit nëpërmjet institucioneve të kulturës, duke krijuar edhe hapësira dhe mundësi për shtimin e shkëmbimit të aktiviteteve kulturore edhe ndërmjet skenës së pavarur kulturore të të dy vendeve. Ministrat u pajtuan t'i fillojnë procedurat për përgatitjen e një kalendarit të përbashkët kulturor në mes të Kosovës dhe Maqedonisë, i cili orientimisht pritet të nënshkruhet në muajin shtator.

Ministri Gashi u shpreh se bashkë me homologun Ademi janë pajtuar për një kalendar të përbashkët kulturor. "E kemi një kalendar të tillë me Republikën e Shqipërisë. Një të tillë dëshirojmë ta kemi edhe me Republikën e

Maqedonisë. Pse jo pastaj ta kemi një kalendar të përbashkët mes Kosovës - Shqipërisë dhe Maqedonisë, ku do të përfshihen institucionet e kulturës që të kenë aktivitete të përbashkëta", ka thënë ministri Gashi, duke shtuar se janë pajtuar t'i autorizojnë institucionet e kulturës të bëjnë aktivitete të përbashkëta. "Një datë e përbashkët, aktivitete në teatër, në filarmoni, në balet, gjithashtu të kemi shkëmbime të ansambleve tona me ansamblet e Maqedonisë dhe ato që veprojnë në komunat me shumicë shqiptare apo edhe ansamblet e tjera në Maqedoni sepse Kosova edhe shqiptarët edhe atje kanë një gjuhë, një kulturë dhe një traditë të përbashkët", është shprehur



ministri Gashi.

Ndërkaq ministri i Republikës së Maqedonisë, Asaf Ademi, u shpreh se ndihet jashtëzakonisht i nderuar që vizitën e parë zyrtare që nga marrja e mandatit po e realizon në Kosovë. "Është nder për mua që gjatë takimit me ministrin biseduam për mundësi të reja për ta zhvilluar kulturën", u shpreh ministri Ademi.

Ndër të tjera, në takimin e zhvilluar të dy ministrat e informuan njëri-tjetrin për punën që ministrat po bëjnë për përkrahjen dhe avancimin e kulturës përmes politikave dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të organizatave kulturore.

Gashi e Ademi diskutuan edhe për avancimin e legjislacionit. Ademi e njoftoi ministrin Gashi për përgatitjen që po bëjnë për ligjet e reja për kulturë dhe trashëgimi kulturore. Ministri Ademi vuri theksin se po angazhohen që nëpër institucione e mekanizma të tjera të kulturës të bëhet një përfaqësim sa më dinjitoz dhe i drejtë, ku po përfshihen edhe njerëz nga komunitetet pakicë e jo vetëm nga komuniteti shumicë maqedonas.

MRI-ja na mundëson shikimin e organeve nga brenda pa ndërhyrje nga jashtë

PRISHTINË, 1 GUSHT - Specialisti i radiologjisë diagnostike, i mjekësisë nukleare, i radio-onkologjisë, Sami Rustemi (1974, Gjilan), i cili jeton dhe punon në Zvicër, ka publikuar librin "Bazat dhe ekzaminimet në MRI", i cili në gjuhën shqipe është shumë i rrallë për shkak se shërbime të MRI-së (Tomografi të Rezonancës Magnetike) në Kosovë kanë nisur të bëhen shumë vonë, kryesisht në klinika private.

Ky libër, "Bazat dhe ekzaminimet në MRI", është ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë lexuesit i ofrohet njohuri bazike, kurse në pjesën e dytë janë përmbledhur metodat teknike se si duhet të realizohen ekzaminimet në tomografinë e rezonancës magnetike TRM (MRI). Në këtë libër studimor dhe praktik janë paraqitur disa prej ekzaminimeve të pacientëve të bëra në disa spitale në Zvicër, aty ku ka punuar dhe punon autori i këtij libri, të cilin e ka botuar shtëpia botuese "Armagedoni". Për këtë libër për gazetën "Epoka e re" ka folur autori i librit, i cili ka treguar se rezonanca magnetike, si teknologjia më moderne në fushën e diagnostikës mjekësore, ka pasur përparim në njëzet vjetet e fundit në vendet e zhvil-



luara perëndimore, kurse në Kosovë ka nisur të përdoret tashti vonë, kryesisht në klinikat private. Rustemi ka thënë se në gjuhën shqipe, edhe pse ka bërë kërkime gjatë hartimit të tekstit të vet, nuk ka gjetur ndonjë libër për MRI-në, prandaj "në këtë libër kam përmbledhur njohuritë e mia për MRI-në të fituara nga përvoja ime më shumë se njëzetvjeçare në klinika të ndryshme në Zvicër në të cilat kam punuar dhe punoj".

Rustemi ka bërë me dije se libri i tij "Bazat dhe ekzaminimet në MRI" u duhet studentëve të lëmit të MRI-së dhe profesionistëve teknikë të cilët janë të angazhuar

në institute të ndryshme të radiologjisë në Kosovë e të cilëve u mungojnë njohuritë rreth MRI-së dhe përdorimit të sistemit të hapur dhe të mbyllur.

Rustemi ka thënë se MRI-ja, apo tomografia e rezonancës magnetike, mundëson shikimin e organeve nga brenda pa ndërhyrje nga jashtë. Sipas tij, kjo përbën një fushë të fortë magnetike dhe, ndryshe nga rëntgendiagnostika (rëntgeni konvencional apo CT tomografia kompjuterike), në MRI pacientët nuk u nënshtrohen rrezeve të rëntgenit.

Libri është ilustruar edhe me fotografi gjatë ekzaminimeve të pacientëve në MRI. Sipas Rustemit, fotografitë janë të pacientëve anonimë, por nëpërmjet fotografive dhe rasteve të ekzaminimeve mund të kuptohen më lehtë metodat teknike për skanimin e organeve. "Studentët apo personeli profesionist, nëpërmjet imazheve që kam paraqitur në libër, e kanë më lehtë të kuptojnë si duhet të realizohen prerjet në fushat e ndryshme - në rrafshin transversal, koronar apo sagittal, gjegjësisht të bëjnë planifikimin e sekuencave për skanim. I pyetur se cili sistem i MRI-së

është më i saktë, më i përdorshëm, ai i hapur apo i mbyllur, Rustemi ka thënë se të dy sistemet kanë rëndësinë e tyre. "Sistemi i mbyllur ka një fushë shumë më të fortë magnetike. 1-3 Tesla është më i përhapur për shkak të fushës së fortë magnetike, kurse anë negative mund të llogaritet frika nga vendet e mbyllura që ndiejnë disa persona. Ndërkaq, sistemi i hapur ka një fushë shumë më të dobët 0.5 1 Tesla dhe në shumë klinika është sistem dytësor, pasi këtu mund të kryhen intervenime të drejtpërdrejta në pacientë (punksi, biopsi).

Ai ka treguar se ekzaminim në



MRI nuk duhet ta bëjnë ata persona që kanë kundërrindikacione si, p. sh., pacemaker në zemër, pompa të insulinës, pompa kundër dhimbjeve, klipsa metalike, pacientët me temperaturë të lartë (pasi trupi absorbon energji, nxehtësi gjatë skenimit në MRI), shtatzënat në muajin e tretë etj. "Pacientë, para se të bëjnë ekzaminim në MRI, duhet ta mbushin pyetësorin, në të cilin duhet të përgjigjen në secilën pyetje, pasi fillimisht duhet ditur gjendja e tyre shëndetësore", ka thënë Rustemi. Megjithatë, ai ka shtuar se deri më sot nuk ka asnjë rast të regjistruar në të cilin pacientët kanë raportuar dëme nga MRI-ja, e cila mundëson të shohim nëse organizmi ynë i brendshëm ka pësuar ndryshim organik apo funksional.

Rustemi ka thënë se në Kosovë ka mungesë të përvojës në këtë fushë të ekzaminimit të pacientëve në MRI. Ai ka pasur rastin t'i shohë të afërmit e vet nëpër institute të radiologjisë në Kosovë dhe në klinika private dhe aty ka parë mungesë të njohurive bazike të teknikëve të radiologjisë jo vetëm në MRI. Ai ka parë, ndër të tjera, që CT-Thorax skanohen në expiracion e jo në inspiracion.

"Sofra gurbetçare" përçon vlera të mirëfillta kulturore shqiptare

PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Nën përkujdesjen e Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, është mbajtur "Sofra gurbetçare" në Shatërvan të Prizrenit, ku Ansambli "Emin Duraku" nga Zhuri dhe grupe e solistë të tjerë mysafirë kanë performuar me këngë e valle për bashkatdhetarët të cilët po kryejnë pushimet e tyre verore në vendlindje. "Sofra" shtrohet për mërgimtarë në shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi për punën dhe kontributin e tyre që kanë dhënë dhe po japin për

Republikën e Kosovës në përgjithësi, posaçërisht për zhvillimin e jetës kulturore dhe për ruajtjen e traditave shqiptare në mërgatë.

Në kuadër të aktivitetit të organizuar në nderim të Mërgatës u shpërndanë edhe mirënjohje për individë dhe organizatë që kanë kontribuar për zhvillimin e kulturës së Kosovës në vendet e mërgatës ku jetojnë dhe veprojnë shqiptarët, duke e ruajtur kësajsoj traditën, gjuhën e kulturën tonë. Me këtë rast, ministri Gashi, i cili mori pjesë në këtë organizim, u

shpreh se me kënaqësi MKRS-ja dhe pa hezitim e ka përkrahur këtë ngjarje. "Aktivitetet e kësaj natyre, përpos shprehjes së falënderimit për kontributin e bashkatdhetarëve tanë, përçojnë vlera të mirëfillta kulturore. Ne po punojmë vazhdimisht që organizimet e mirëfillta kulturore ta kenë hapësirën dhe përkrahjen e nevojshme ashtu që bashkatdhetarët dhe qytetarët e Kosovës të kenë se çfarë të shohin e dëgjojnë dhe si ministër ndihem jashtëzakonisht i lumtur për këtë", u shpreh ministri Gashi.



Demaçi dhe Rugova, historia e parrëfyer e një mërie politike



Bedri ISLAMI

Në fillimin e pranverës së vitit 1990, në një natë të vetme, ndoshta i gjithë qielli i Kosovës u përflak nga pushkët. Ishte, ndoshta, hera e parë që kishte një dyndje të tillë nëpër rrugë jo për t'i ripërsëritur demonstratat e një viti më parë, të cilat kishin pasur martirët e heronjtë e tyre, si Afrim Zhitia dhe Fahri Fasliu, por në pritjen e një burri, i cili, më shumë sesa një emër, ishte një legendë në më shumë se tri dekada, Adem Demaçi. Ai ishte asaj kohe një pjesë thelbësore e historisë së Kosovës dhe shtëpia e tij, e cila nuk mund të zinte gjithë njerëzit që ishin sulur ta takonin, ishte jo vetëm e vogël, por ai as që kishte ndërmend ta bënte një rezidencë të lëvizjes çlirimtare. Ata që e kishin pritur këtu do të kishin një fillesë zhgënjimi, por bacës së tyre jo vetëm i falen gjithçka, por edhe duhej prituri më tej.

Adem Demaçi në pranverën e vitit 1990, kur mund të ishte shumë lehtë prijësi i shqiptarëve në Kosovë, çuditërisht bëri thirrje të përkrahej Rugova, shefi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e këtë e përsëriti edhe dy vjet më pas.

Demaçi tha fjalët e papritura për njerëzit e lëvizjes çlirimtare se, "Kosovën e kishte lënë dimër dhe e kishte gjetur verë" dhe, këtë "verim" e lidhte me Rugovën, megjithëse ky i fundit kishte qenë në strukturat e njohura politike të Lidhjes Komuniste të Kosovës, sekretar politik në Institutin Albanologjik, e cila ishte cilësuar si qendra e nacionalizmit shqiptar. Demaçi, si dukej, po bënte atë çka u kishte thënë të tjerëve në fjalën kushtuese të librit të tij të njohur, "Gjarpërinjtë e gjakut", se ua kushton "jo atyre që ngrënë gishtin e krimit, por atyre që shtrijnë dorën e pajtimit".

Po vinte pas burgimit të tretë që kishte zgjatur 15 vjet, më shumë se gjysma e dënimeve të tij 28-vjeçare.

Tetë vjet më vonë, në përpjekjet e të dërguarve të Shteteve të Bashkuara, ambasadorit Hill dhe zotit Hoolbruck, për të krijuar në Kosovë, pas marsit të vitit 1998, një qendër të përbashkët koordinimi politik, pikërisht më 4 korrik, Demaçi, duke ngulur këmbë që Rugova të kthehej në shtëpinë e tij si qytetar i zakonshëm, pasi politi-

ka e tij kishte dështuar, duke refuzuar postin e kryeministrit të Kosovës, do t'u thoshte atyre se "Nuk është në interes amerikan të përkrahet një politikan krejtësisht i dështuar, çfarë është Rugova". Ai do të shtonte se "Rugova duhet të tërhiqet plotësisht, ai duhet të kthehet në banesë. Ju mund të bëni çfarë të doni... Më në fund, nuk është hera e parë e, qe besa as e mbrema, si po shoh, që ai juve do t'ju mashtrorë... E keni mbajtur në pushtet, vazhdoni ta mbani edhe tash e tutje. Falë ju qoftë!"

Biseda do të sillte shpërthimin e zotit Hoollbruck: "Kësi takimi kurrë nuk kam pasur... Ai, Demaçi, nisi të piskasë. Merre me mend, Demaçi po na mëson neve se cili është interesi amerikan në Kosovë dhe me kë duhet të bashkëpunojmë e me kë jo. Nëse merreni vesh ju, qysh sot mund ta shpallim Këshillin, Trupën e Përbashkët e çfarëdo tjetër. Dhe brenda tij i dua edhe Demaçin, edhe Qosen. Dhe, nëse mendoni se Demaçi duhet të jetë patjetër në krye të tij, ashtu do të jetë".

Demaçi kundërshtoi përsëri. Ai, deri në fund, me gjithë presionin e gjithkrahshëm, do të mbetej në mendimin e tij: Rugova duhej të largohej nga skena politike. Ai kishte dështuar, ai kishte mbajtur zgjedhjet e 22 marsit 1998, kur lufta kishte nisur, kishte përjashtuar Drenicën nga zgjedhjet dhe pas operacionit serb të qershorit kishte deklaruar se "tani jam më i fortë".

Çfarë kishte ndodhur mes këtyre dy burrave, tek të cilët ishte varur një pjesë e madhe e shpresës së Kosovës dhe të cilët, megjithëse të ndryshëm në shumëçka, për të mos thënë në të gjitha, ishin bërë tashmë dy veta që e përjashtonin njëri-tjetrin deri në fund?

Vdekja e Adem Demaçit, figurës më të shquar të rezistencës shqiptare në mesin dhe fundin e shekullit të shkuar dhe emblema rreth së cilës mblidheshin njerëzit në këtë shekull, sidomos varrimi i tij, zgjoi dhe hapi edhe një herë meritë e vjetra politike, të cilat, herë të hapura dhe herë të tjera brenda vetes, në shumë raste kanë qenë të njohura, por që nuk është menduar se do të shkonin edhe pas jetës, në ditëvdekje.

Njerëzit e Rugovës, pra, të partisë që ai la pas vetes, herë të gjymtuar dhe herë të ndjeshme, papritmas, si të vinin drejtpërdrejtë nga lufta e ftohtë e një kohe të shkuar, deklaruan se nuk do të jenë pjesë e varrimit të Demaçit dhe, disa prej tyre, shkuan edhe më tej se kaq, duke synuar përdhosjen e një figure

që i kishte bërë nder qëndresës shqiptare në Kosovë.

Si duket ka qenë një lëvizje politike e llogaritur ftohtësisht, si një hapje e hesapeve të vjetra që kanë qenë mes Demaçit dhe Rugovës, por edhe si një hakmarrje e vonë e një lëvizje politike, e cila, pasi doli nga Lidhja Komuniste e Kosovës, kishte qenë pjesë politike e tri dënimeve të zgjatura të Demaçit, njeriut që kishte turbulluar shumë ujëra të ndenjura dhe nuk kishte lënë të humbiste mendimi se mund të kishte rezistencë në Kosovë.

Rasti i Demaçit është shumë i ngjashëm me atë të Ukshin Hotit, staturës tjetër të shquar politike në Kosovë që, po ashtu si Demaçi, kishte rënë nën mërinë politike të Lidhjes Demokratike dhe shefit të saj dhe që, kur ishte ridënuar, e vetmja gjë që kishte thënë kjo strukturë politike do të ishte se "Ukshin Hoti ishte ashtu si ishte" dhe ishte lënë në harresën e tij.

Përse u zgjuan tani "hesapet" e vjetra mes dy figurave ndër më të njohura të politikës shqiptare në Kosovë: Demaçit dhe Rugovës? A do të kishte ndodhur kjo nëse Rugova do të ishte ende në jetë apo kjo që ndodhi, kjo shfaqje e hapur refuzimi për të nderuar një figurë kaq shembematike, do të ishte shmangur nga ish-presidenti i Kosovës?

Ku filloi mëria e tyre, më saktë, kjo ndarje e hershme politike mes njërit e tjetrit dhe a ka pasur raste kur ato kanë qenë së bashku, në një vijë, ashtu si edhe në vija të ndryshme?

Demaçi dhe Rugova u takojnë dy lëvizjeve të ndryshme politike jo vetëm pas vitit 1990, kur në Kosovë u krijua një tablo fantazmagorike e lëvizjes pluraliste, por edhe shumë më herët. Si njëri ashtu edhe tjetri ishin njerëz të letrave. Demaçi ishte më shumë shkrimtar, Rugova e kishte lidhur veten më shumë me kritikën letrare. Romani i Demaçit, "Gjarpërinjtë e gjakut", do të jetë për disa dekada mishërimi i aspiratës së shqiptarëve, për të falur gjaqet brenda vetes dhe për të qenë së bashku ndaj një armiku tjetër; ndërsa studimet e Rugovës, sidomos për Buzukun, do të jenë sinjale të një pune studimore serioze, por që u ndalën pas futjes së tij në thellësinë e politikës, pasi kishte qenë shumë vite në ujërat e ndërmjetme.

Demaçi dhe Rugova kishin përfaqësuar që herët dy rryma të ndryshme politike, nganjëherë të kundërta dhe në disa raste dy rryma që përjashtonin njëra-tjetrën.

Demaçi kishte ardhur në poli-

tikë përmes qëndresës. Në fakt, ai ishte një nacionalist i bindur që kishte lëvizur lëvizjet marksiste, të cilat do t'i hedhë pa asnjë drojë e dhimbje menjëherë pas vizitës së tij të parë në Shqipëri. Egon nacionaliste do ta mbajë deri në fund pas vetes. Rugova, me një fillesë të çuditshme në politikë, ka të dhëna se babai i tij, Ukë Rugova, është vrarë nga forcat serbe pas vitit 1945, do të bëhej shumë shpejt anëtar i Lidhjes Komuniste të Kosovës dhe njeri i besuar i saj. Në kohën e burgimit të parë të Demaçit është edhe pranimi i Rugovës në parti.

Në kohën e burgimit të dytë të Demaçit do të jetë edhe rritja e parë politike e Rugovës brenda suazës komuniste kosovare dhe serbe, pasi Lidhja e Komunistëve të Kosovës varej drejtpërsëdrejti nga Lidhja Komuniste e Serbisë.

Në ditët e burgimit të tretë të Demaçit, tani në Starogradshkë, në Kroaci, Rugova do të ketë dy rritje politike, si sekretar i LKK-së dhe kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve deri në fundvitin 1989 dhe pas pak si kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Megjithatë, ata, herë pas here, e gjetën gjuhën e rrugën e përbashkët. Deri në mesin e vitit 1996 ata ishin një zë i përbashkët, por me disa nuanca të ndryshme.

Demaçi do të thyhej ngadalë nga besimi që kishte pasur dhe, ashtu si ishte, pak i vështirë për të punuar me të, shumë i drejtpërdrejtë dhe i hapur, impulsiv dhe rezatues njëkohësisht, do ta kishte gjithnjë e më të vështirë ta pranonte ecjen e ngadaltë të Rugovës dhe do të zemërohej me deklarimet e tij politike ndaj UÇK-së.

Rugova, nga ana tjetër, më i qetë, më llogaritës, aspak impulsiv, me një besim të perëndimorëve ndaj tij, që herë zbehej dhe herë rritej, por që ishte një besim i pranishëm, nuk harronte kurrë në zemërimin e tij, megjithëse nuk e shfaqte. Demaçi, pas emërimit të tij nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, që ta riprezantojë UÇK-në në procesin e unifikimit të forcave politike shqiptare dhe krijimit të institucioneve të reja të Kosovës, kishte ngritur zyrën në Prishtinë, kishte marrë pas vetes disa djem të rinj, mes të cilëve shquante Albin Kurti dhe fliste me një gjuhë krejt ndryshe nga ajo e Rugovës.

Krisja e tyre e parë erdhi në vitin 1996 dhe erdhi nga shteti shqiptar dhe presidenti i kohës, Berisha.

Po afrohej kriza e piramidave dhe synimi i shtetit shqiptar ishte që një pjesë të krizës të

deportohej në Kosovë. Duheshin krijuar lëvizje politike dhe mosbindje qytetare, të cilat binin ndesh me politikën e Kosovës. Duhej krijuar një kauzë jashtë Shqipërisë, që të kërkonte pjesëmarrjen e Berishës në zgjidhjen e saj dhe, pavarësisht se vendi nuk ishte i përgatitur ende dhe UÇK-ja ishte në fazat e zhvillimit, duke u shtrirë në disa zona, kështu që mund të kishte pasoja të pandreqshme, Berisha kërkoi të lëvizë boshtin.

Ai thirri në Tiranë Hydajet Hysenin, asaj kohe nën kryetar i LDK-së, ish i burgosur politik dhe kërkoi të rriste protestat. Me gjithë autoritetin e tij të dyfishtë, Hyseni nuk lëvizi gjë dhe më pas, ai bashkë me shumë të burgosur të tjerë politikë, Rugova i largoi qetësisht nga LDK-ja.

Pas tij, në lojë, ndoshta verbas, por me dëshirë për ndryshim, hyri Demaçi. Ishte një frut i papjekur ende dhe kështu që ra. Vetëm në vjeshtën e vitit 1997, kësaj here nën drejtimin e Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe Unionin Studentor, nisi lëvizja e qëndresës përmes demonstratave.

Rugova nuk ia harroi kurë këtë Demaçit. Ai nuk bëri nota verbale apo protesta në publik. Ai vetë heshti, por njerëzit e tij, në media dhe përmes Qendrës për Informim të Kosovës, u sulën ndaj Demaçit. Ashpërsisht. Demaçi u ashpërsua edhe më shumë.

Ndarja e dytë, më e madhe e më reale, ishte në qëndrimin e tyre ndaj UÇK-së. Ndërsa njëri, Rugova, i mohonte krejtësisht, tjetri, Demaçi, ishte zëdhënës i tyre. Nuk kishte se si të ndodhte ndryshe.

Ishin dy njerëz që i takonin dy mendimeve të ndryshme politike, kishin bërë rrugë të ndryshme dhe kishin pasur qëndrime të kundërta.

Por, të dy, duam apo nuk duam, ishin e mbeten pjesë e historisë së Kosovës.

Demaçi, kundërshtari i rreptë i Rugovës, pas largimit nga jeta të këtij të fundit, nuk e përmendi asnjëherë negativisht. Ai heshti në shenjë nderimi për njeriun me të cilin kishin pasur përpjekje të mëdha dhe ishin përplasur sa herë kishin dashur.

Nëse Rugova do të ishte gjallë ende, nuk jam i bindur nëse do të kishte qenë pjesë e ceremonialit të Demaçit. Jo vetëm sepse ishte idhnak i pandreqshëm që nuk harronte kurrë, por edhe nga precedentit tjetër: sa ishte në jetë ai nuk vajt asnjëherë tek Kullat e Adem Jasharit dhe Jasharëve të tjerë.

Nuk e di përse ishte bërë idhnak edhe ndaj tyre, ose më saktë, edhe nëse e di, kjo nuk është temë e këtij shkrimi.

Epoka demaçiane



Izmi ZEKA

Edhe pafundësisht të shkruhet Epoka demaçiane është e vështirë të portretizohet dhe të zhvishet ashtu si duhet dhe të shtjellohet mbi bazën shkencore dhe historike.

E themi këtë për dy arsye të veçanta të cilat marrin kohë dhe hapësirë por, përveç kësaj, edhe disonanca krijon pamundësi për një vështrim realist dhe pa qenë i ndikuar. E para, ose fakti i të jetuarit në një kohë kur jeta kishte çmimin e vet dhe ngritja mbi këtë çmim dhe, e dyta, refleksioni përtej një Kosove të vogël dhe të panjohur ndërkom-bëtarisht.

Epoka demaçiane më shumë se sinonim është ide projekt, platformë që historia e Evropës pak njihet projektues të kësaj filozofie. Filozofia demaçiane, për dallim prej të tjerëve të Ballkanit e më gjerë, ka konceptin dhe jo figurën, idenë dhe jo individin. Me një fjalë, ka tërësinë dhe lirinë si aspekt fundamental jetësor.

Analizat historike e shkencore nisen mbi substancën e veprim-it dhe faktografisë si element bazë për ndërtimin e ngjarjeve dhe përjetimeve në kohë, duke sintetizuar fundamentin e të arriturave mbi bazën e shpërfaqjeve tokësore të ngjarjeve, kohëve, rezultateve, çasteve, kthesave dhe shumë faktorëve të tjerë.

Nga këto premisa Epoka demaçiane ruan ndërtimin e një kompleksiteti shtetëror të konfiguruar natyrshëm mbi idenë universale e që janë të drejtat për gjithë njerëzimin pa dallim. Ky është arti që gjysmën e dytë të shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI e kthejnë në idenë, programin që kalonte prapë e individit të shikuar nga këndi i paqes dhe stabilitetit të popujve.

Demaçianët paraqesin filozofinë praktike të rezistencës aktive deri në çlirim, por edhe luftën për drejtësi për të gjithë, pa dallim etnie që nga kultura evropiane që është filozofi e re dhe shumë e rëndësishme për emancipimin ballkanik e përtej saj.

Studiuar këtë filozofi, del në pah humaniteti dhe emancipimi shoqëror që botës së alarmuar i ndihmon në rrugëzgjdhje përtej individit dhe mundëson zgjidhje të pranueshme në çdo moment.

Historia e shqiptarëve njihet

epokën e Skënderbeut, epokën e rilindësve që bënë kthesë dhe tani lirshëm mbi çfarëdo baze shkencore shohim epokën e kthesës që në trajtimin historik kemi Epokën demaçiane.

II

Madhështia e një populli nuk qëndron tek forca e tij, as të madhësia e tij... Madhështia e një populli qëndron tek shpirti i tij. Vetëm një popull me shpirt të madh mund të lindë njerëz të mëdhenj, njerëz që kohën e tyre e kthejnë në epokë të njerëzimit, njerëz që nga thjeshtësia e tyre ngritën e bëhen heronj të kohës së tyre.

I tillë ishte baca Adem. Ai u ngrë nga vegjëlja, sfidoi regjimin më të tmerrshëm të kohës dhe si një yll ndriçoi shpirtin dhe mendjen e njerëzve të shtypur, njerëzve të përbuzur e të nënçmuar, njerëzve që kërkojnë dhe meritojnë lirinë.

Ai e shënoi epokën e tij, me guxim, me dije, me humanizëm... Ai e sfidoi vuajtjen, e sfidoi dhimbjen e trupit e shpirtit, robërinë e ktheu në luftë për liri...

Ky njeri i këtij populli të vogël në numër, ndriçoi si një rreze dielli në qiellin e turbullt të Evropës. Ai i dha njerëzimit shembullin e njeriut të mirë, shembullin e mundësive të pafundme njerëzore... Jetën e tij dhe veprën e tij e ktheu në një epokë të njerëzimit, vuajtjet e tij i shndërroi në një besim për njeriun (tamam si Jezusi), fjalët e tij u shndërruan në një dashuri për kombin e për njerëzimin... Kreatori i politikës moderne në Kosovë dhe projektuesi i saj Ukshin Hoti për të gjallë të Adem Demaçit shkruan citoj:

"Për këtë shkak figura e tij e rëndomtë në mënyrë gati të padiskutueshme kaloi në legjendë; u tret në shpirtin e gjallë të popullit dhe u mishërua me ëndrën e tij shekullore; Demaçi dhe populli u bënë një. Nuk ishte më tutje vetëm një bir i denjë i popullit, por gati vetë populli. Për politikën tani e tutje ishte i rrezikshëm, për aq sa ishte i rrezikshëm vetëdijesimi politik i popullit shqiptar". Këtë ai e artikuloi me inteligjencën e tij të mprehtë, me shpjegimet e thjeshta, por definitive dhe të prera, me referencat e tij shpatë që copëtonin, por që nuk therrnin.

Më mirë dhe fjalim profetik se Ukshin Hoti për Demaçin është e vështirë të gjendet në shkrimet tona. Ukshin Hoti si politikan, orator, shkencëtar Adem Demaçin e zbërthen deri në imtësi dhe tregon për peshën që ka ky njeri i shndërruar në mit.

Kjo profeci e Ukshin Hotit për Demaçin e bënë të paprekshëm

shekullin e kaluar vetëm sa i shton realitetin dhe diferencën ndaj të tjerëve dhe vlerësimit kohë.

Epoka demaçiane ka vijëmesinë ku dy pole të ndryshme i kap natyrshëm dhe i përçon në vlerën njerëzore. Koncepti i tillë shtrihet përtej krijesës njerëzore që ai e koncepton të madhërishëm dhe të paprekshëm nga askush, pra ai nuk njihet pushtues, as edhe barbar të çfarëdo ngjyre të jenë.

Kush më mirë se në epokën e tij u ngrit mbi dallimet njerëzore, mbi të drejtën e popujve për të qenë të lirë, dhe nga kjo kemi qëndrueshmërinë deri në flijim për civilizimin evropianë, dhe jo vetëm kaq, mbi vlerat universale të qytetërimit botëror.

Përmendët shpesh Nelson Mandela apo filozofia e Mahatma Gandit, dy figura emblematike të një procesi jo të lehtë që bota thirret herë pas here në vlerat e tyre.

Demaçi apo demaçianët tani kanë krijuar dimensionin epik, lirik, patriotik të një kohë pa kohë, ku regjimi shtypte pa zhurmë qasjen kombëtare ende pa filluar mirë. Por koncepti demaçian nuk ka pikëpresje deri në realizimin e aspiratave shekullore. U bë jetë, zhvillim, prosperim, forcë dhe vetëdijesim deri në ngritjen e një niveli që për shekullin e kaluar i kalonte përmasat ballkanike. Misioni demaçian nëse përkthehet në thjeshtësi ka rregullimin shtetëror, humanitetin dhe arsyen si shprehje e mosdallimit të racave njerëzore. Këtu dhe qëndron madhështia e kësaj filozofie e shndërruar në plat-

formë dhe art i prosperimit të popujve për të qenë të lirë dhe të barabartë.

III

Adem Demaçi ka lënë shumë në historinë e tij. A s'është profeci apo thënë qartë platformë kjo mbrojtje në gjykimin e parë në mars të vitit 1959 po citoj: "Prej këtu ku jam, po iu them edhe një herë se nëse Serbia e Jugosllavia nuk heqin dorë nga okupimi i Kosovës dhe nëse nuk lejojnë që Kosova të shkëputet nga Jugosllavia e t'i bashkohet Shqipërisë, atëherë nuk do të ketë paqe as në Ballkan, as në Jugosllavi e as në Serbi. Nëse Serbia do të vazhdojë me këtë politikë ndaj shqiptarëve, një ditë Serbia ka për t'u bërë shkakare e shpartallimit të krejt Jugosllavisë dhe në fund do të mbetet edhe pa Kosovën. Kaq". Epoka demaçiane parashikoj edhe fundin e një sistem totalitar. A nuk është profetike parashikimi i Demaçit se si do të ndodh me sistemin e kalbur Jugosllav.

Në cilën pjesë të historisë gjen figura të tilla që bëjnë njësh me popullin dhe vetë populli merë mbi supe përgjegjësit historike duke u bazuar në veprimet konkrete të demaçianëve.

Edhe Metush Krasniqi bashkëveprimtar dhe ndjekës i kësaj rruge thekson po citoj: "Për mua dhe Adem Demaçin synim jetësor ka qenë bashkimi kombëtar. Me Adem Demaçin jemi pajtuar se qëllim jetësor i yni ishte çlirimi i Kosovës dhe viseve tjera shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia dhe bashkimi i tyre me Shqipërinë. Ndërsa,

sa i përket sistemit komunist në Shqipëri, ishim të bindur se nuk do të duhej të merreshim me të, sepse ai me kohë do të binte".

Demaçianët ideologji kishin bashkimin kombëtar dhe përtej saj synonin mirëqenien e Ballkanit dhe futjen e saj në vendet me civilizim. Pra aty nuk kishte urrejtje as hakmarrje, ky është fakti që e bënë të dallueshëm këtë epokë të rëndësishme historike. Paramendoni 28 vjet burgim dhe urrejtja nuk ekziston. Filozofia që i duhet edhe sot Evropës së civilizuar. E ardhmja do të tregoj në cilindro fushë se epoka e Demaçit u dha fund klithjeve çnjerëzore të atyre që bënë padrejtësi, të atyre që jetonin me gjuhën e forcës, të atyre që nuk njihnin të drejtat dhe liritë njerëzore.

IV

Për fund pak më ndryshe kur vdes Ati i shenjtë

Ati im sot u përcolle në varrezat e dëshmorëve. Ani Atë, mos ke mërzi, ata që dje ty të shanë edhe sot nuk ishin tek ti. Kishin mbajtur mëri Atë, por ti s'mban inat. Edhe pa i pyetur fare re në burg, ishe veç 28 vjet. Atë edhe kur tregoj se fitorja po troket ata s'të besonin, edhe kur ti flisje për ushtri ata s'të besonin prandaj, Atë, kuptoj kanë mbetur të harruar dhe e di që ti s'mban mëri. Ati im i shtrenjtë, as edhe lule s' të vendosën sepse kanë bërë be në Jezu Krishtin e dikush në Muhametin, por s'ka rëndësi, ti i ke falur herët se qëmoti kishin vdekur.

Atë për mua, për Kosovën, fali edhe sot e nesër. Je mësuar të falësh.



E rrallë

Duart gjigante 'mbajnë' urën 1 500 metra të gjatë

Një urë e re madhështore rreth 1 500 metra e gjatë është hapur në Vietnam dhe mbahet nga duart gjigante. Ura e artë është në malet e larta të qytetit "Truong Son" dhe është rreth 1 500 metra mbi nivelin e detit. Në fund të urës janë duart gjigante që duken sikur e mbajnë gjithë urën. Edhe pse është hapur muajin e



kaluar, duart janë dizajnuar në një mënyrë që duken sikur kanë qëndruar aty për vite.

BARSOLETA E DITËS



- Gjakovari**
- Sa kushton një trileqe?
 - Një euro.
 - Ma sill pra një leqe.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

“INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



FOTO E DITES



Alpinistët kanë vendosur flamurin kombëtar të Zvicrës në malin Santis. /Reuters/

Në ora 18:20 “FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed




Në ora 22:00 “LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

E jashtëzakonshme

Studentja thyen rekordin, hanë 255 qebapë për 23 minuta

Një studente nga Turqia ka arritur ta thyejë rekordin duke ngrënë një numër të madh qebapësh në shkopinj për vetëm 23 minuta. Gjeren Yilmaz ka hëngër 255 qebapë duke i shoqëruar me tre gota ajran (pije jogurti turke) dhe dy gota me ujë. Gara u organizua nga pronari i objektit hotelier, i



cili ndodhet në qarkun Kepez, Ilyas Demir dhe aty u paraqitën 21 studentë.



DASHI
Punët shkojnë mirë, por disa përplasje në kohët e fundit ju kanë vënë përpara një vendimi të prerë. Jeni të sigurt për hapin që po ndërmerrni.



DEMI
Këtë periudhë jeni ju armiqtë më të këqij të financave tuaja. Po harxhoni pa fund dhe duket se kjo gjë po ju pëlqen, por shumë shpejt do të mbeteni ngushtë nga lekët.



BINJAKËT
Ditë e vështirë sa iu përket ndjenjave dhe pasionit. Shumë dyshime do të lindin nga hiçi dhe humori juaj do të jetë me ulje ngritje të mëdha.



GAFORRJA
Sot jeni të ndjeshëm dhe intuita do t'ju sugjerojë të gjendeni pranë miqve që kanë më tepër nevojë për ju në këto çaste.



LUANI
Ana sentimentale lë shumë për të dëshiruar sot dhe ju vetë nuk po investoni sa duhet. Çdo vëmendje tuajën e ka përfshirë puna.



VIJGJËRESHA
Dita është mjaft premtuese për ju dhe projektet që keni marrë përsipër. Çdo gjë po shkon sipas planeve dhe nuk do të mungojë humori.



PESHORJA
Instikti juaj nuk gabon sot dhe do të shikoni që mjaft situata që po zhvillohen ju i kishit menduar më parë. Ju ka humbur besimi tek njerëzit.



AKREPI
Ju dhuron dashuri pa kushte dhe kjo gjë ju pëlqen. Megjithatë jeni zhgënjyer nga një person do të mundoheni ta rikuperoni raportin.



SHIGJETARI
Jeni shumë mirë me financat sot dhe kjo ju ka sjellë mjaft qetësi shpirtërore, gjë që nuk mund të thuhet për dashurinë që ju mundon gjithmonë.



BRICJAPI
Sot mjafton të lini pas krahëve të kaluarën tuaj dhe brejtjen e ndërgjegjes dhe gjërat do të jenë më të qarta dhe më të thjeshta.



UJORI
Xhelozia sot do ta shoqërojë raportin në çift. Një situatë jo dhe shumë e qartë do t'i lëkundë ekuilibrat që kishit vendosur me njëri-tjetrin.



PESHQIT
Sot jeni të qetë me gjithë vullin e madh që ka dita. Keni mundur të vini përpara punët e papritura që ju kanë dalë dhe tashmë shijoni momentin.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

RANGERS - NK OSIJEK

1

AZ - KAIRAT

1

KF DRITA - F91 DUDELANGE

1

Drita beson fuqishëm në kualifikim

Ardian Limani është optimist se rezultati i ndeshjes së parë 2-1 e favorizon Dritën për kualifikim në raundin tjetër në Ligën e Evropës. "Gjasat për kualifikim janë shumë të mëdha, pasi na duhet vetëm një gol, aq më tepër që luajmë si vendës. Atmosfera është shumë e mirë në skuadër dhe të gjithë jemi optimistë se mund të fitojmë", ka thënë Ardian Limani, kapiten i Dritës

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 GUSHT - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, është paraqitur mirë në ndeshjen e parë ndaj F91 Dudelange në Luksemburg, por në fund është dashur të pajtohet me humbje. Gjilanasit ishin duke fituar në pjesën e parë me golin e shënuar nga Xhevdet Shabani, por në pjesën e dytë nuk ishin të koncentruar sa duhet në mbrojtje dhe pësuan dy gola që në fund i sollën humbjen. Rezultati nga ndeshja e parë i jep shpresë të madhe skuadrës së Dritës që në ndeshjen kthyesë të raundit të dytë në Ligën e Evropës të marrë rezultat të favorshëm dhe të kualifikohet

tutje. "Gjasat për kualifikim janë shumë të mëdha, pasi na duhet vetëm një gol, aq më tepër se luajmë si vendës. Atmosfera është shumë e mirë në skuadër dhe të gjithë jemi optimistë se mund të fitojmë", ka thënë Ardian Limani, kapiten i Dritës.

Më pas mbrojtësi i Dritës tregoi se kundërshtari pikën më të dobët e ka në repartin e mbrojtjes dhe këtë gjë duhet ta shfrytëzojnë sulmuesit për ta eliminuar skuadrën e Dudelanges nga Liga e Evropës. "Për ndeshjen kthyesë na mungojnë Endrit Krasniqi dhe Viktor Kuka për shkak të kartonëve, por jemi optimistë se mund t'ia dalim. Kundërshtari ynë pikën më të dobët e ka mbrojtjen e ngadaltë, e cila do të përballet me

sulmin tonë që është shumë i shpejtë dhe në këtë pikë jemi mjaft mirë të favorizuar", ka deklaruar Limani, duke thënë se pret një përkrahje të madhe nga tifozët në ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Adem Jashari" nga ora 20:45. "Si gjithmonë, presim nga 'Intelektualët' të na japin përkrahjen e madhe siç dinë vetëm ata dhe të na shtojnë drejt fitores", ka shtuar ai.

Një mobilizim të madh për këtë ndeshje e kanë bërë edhe tifozët e Dritës, "Intelektualët", të cilët kanë paralajmëruar se fillimisht do të takohen në qendër të Gjilanit në orën 15:00, më pas do të nisen drejt Mitrovicës me dhjetë autobus dhe qindra vetura për ta përkrahur skuadrën e zezës.

SHKURT

Haradinaj: Flamuri i Kosovës po lartësohet në majat më të larta botërore

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim Arineta Mula, e cila kohë më parë ka pushtuar majën më të lartë të botës, Mount Everest. Me këtë rast Haradinaj ka inkurajuar Arinetën në sfidën e saj të radhës, ngjitjen në Mount Elbrus. Sipas Haradinajt, njerëzit e sfidave të mëdha po e lartësojnë flamurin e Kosovës në majat më të larta botërore. "Kosova ka njerëz të guximshëm, që e sfidojnë veten dhe rrethanat në të cilat jetojnë, duke tejkaluar lartësitë jo vetëm fizike, por edhe mendore. Një ndër ta është Arineta Mula, e cila kohë më parë ka pushtuar majën më të lartë të botës, Mount Everest. Mëngjesin e sotëm pata kënaqësinë ta inkurajoj Arinetën në sfidën e saj të radhës, ngjitjen në Mount Elbrus. Njerëzit e sfidave të mëdha po e lartësojnë flamurin e Kosovës në majat më të larta botërore".

Tusha "aterron" në Prizren

Liria e Prizrenit vazhdon të sjellë risi në prag të edicionit të ri në Superligë. Pas rikthimit të lojtarëve prizrenas, bardhezinjtë "godasin" sërish në Shqipëri, duke transferuar këtë herë ish-lojtarin e Tiranës dhe Partizanit të Tiranës, Gerald Tusha. Mesfushori Tusha, prodhim i akademisë së Tiranës, i transferuar te Dinamo, mandej te Partizani e Tërbuni. Sezonin e shkuar e mbylli në Maltë te Ghajnsielem, ndërsa sot ka nënshkruar me Lirinë.

Pogba takohet me Abidalin, shkak transferimi te Barça

Paul Pogba dëshiron të largohet nga Manchester Unitedi dhe destinacioni i tij pritet të jetë Barcelona, raporton "Tuttosport". Mesfushori francez ka zhvilluar një takim në Los Angeles me sekretarin teknik të Barcelonës, Eric Abidal. Pogba ka një kontratë me Manchester Unitedin deri në vitin 2021, por raportet jo të mira me Jose Mourinhon mund të ndikojnë në largimin nga "Old Trafford".

Reali "harron" Hazardin, dëshiron dyshen Salah - Kane

Skuadra kampione e Evropës, Real Madridi, është duke e kërkuar një zëvendësim ideal për Cristiano Ronaldo, i cili është transferuar në Juventus. Fillimisht drejtuesit e Realit synuan transferimin e Eden Hazardit nga Chelsea, por tash duket se ata e kanë "harruar" këtë futbollist dhe janë fokusuar nga dy yjet e Premierë Ligës, Mohamed Salah (Liverpool) dhe Harry Kane (Tottenham Hotspur).

Rikthehet liga e medieve, "Epoka e re" synon mbrojtjen e titullit

PRISHTINË, 1 GUSHT - Liga e medieve pritet të rikthehet pas një pauze shumë të gjatë. Kjo ligë ishte organizuar për herë të fundit në vitin 2010, kurse vendin e parë e kishte fituar ekipi i gazetës "Epoka e re". Drejtori i gazetës "Express" dhe i

televizionit "T7", Berat Buzhala, nëpërmjet një statusi në "Facebook" ka konfirmuar se kjo ligë do të fillojë në muajin shtator dhe se deri tash e kanë konfirmuar pjesëmarrjen këto medime: "Klan Kosova", "Gazeta Express",

"T7", "KTV", "Telegrafi", "Epoka e re", "Lajmi", "Zëri", "InfoKosova", "Prishtina Post", "Fakteplus", "Prishtinesot".

Ekipi i gazetës "Epoka e re" synon ta mbrojë trofeun e fituar tetë vjet më parë.



Morina, drejtor sportiv i Prishtinës

PRISHTINË, 1 GUSHT - Arbnor Morina pas një kohe të gjatë është rikthyer në skuadrën e Prishtinës. Ish-futbollisti, trajneri dhe drejtori gjeneral do të jetë zëvendësues i Arsim Thaqit në postin e

drejtorit sportiv. "Me dëshirën më të madhe kam pranuar ofertën e kamotshme të kryetarit Ejupi që të rikthehem në klubin tim të zemrës. Më parë isha drejtor ekzekutiv e tani drejtor

sportiv, por kjo më së paku çon peshë, sepse gjithmonë çfarëdo pune kudo që kam punuar, jam munduar të jap 200 % nga vetja ime. Ndërsa objektivat dihen, ato gjithmonë janë të njëjta në

Prishtinë, si lufta për tituj dhe organizimi pak më ndryshe, duke tentuar të gjejmë kryesisht futbollistë që do t'i shërbejnë ekipit dhe të jenë interesant për treg dhe shitje", ka thënë Morina.



Superliga fillon me derbin Feronikeli - Trepça '89

PRISHTINË, 1 GUSHT - Komisioni i Garave i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), në praninë e përfaqësuesve të klubeve të Superligës dhe Ligës së Parë, ka bërë të mërkurën tërheqjen e shortit për edicionin e ri të garave. "Edicioni i ri të nisë sa më mirë, të zhvillohet në mënyrë korrekte dhe rezultatet të jenë si rrjedhojë e asaj që do të tregojnë në fushë ekipet. Besoj, sikur edhe deri më tash, do të kemi një edicion të mirë dhe derisa të zgjidhet sponsori i ri i Ligës, ajo të quhet vetëm si Superligë", ka thënë Eroll Salihu, sekretar i përgjithshëm i FFK-së.



SUPERLIGA - JAVA E PARË

Drita - KEK-u
Flamurtari - Ferizaj
Liria - Ballkani
Llapi - Drenica
Feronikeli - Trepça '89
Prishtina - Gjilani

LIGËN E PARË - JAVA E PARË

Dukagjini - Fushë Kosova
Ramiz Sadiku - Drenasi
Onix - 2 Korriku
Vllaznimi - Vushtrria
Arbëria - Bashkimi (Koretin)
Kika - Istogu
Vllaznia (P) - BesaVitia - Trepça

Williamsi përjeton makthin më të madh të karrierës



WASHINGTON, 1 GUSHT - Tenistja amerikane Serena Williams, fituesja e 23 grand slameve në karrierë, një prej ikonave të këtij sporti, ka zhgënjyer në turneun e San Joses, ku ka nisur përgatitjet për grand slam të US Open. Ajo është mundur 2-0 (6-1, 6-0) në 52 minuta lojë nga tenistja britanike Johanna Konta, në një ndeshje ku Serena ka luajtur shumë dobët, duke zhgënjyer. Kurrë më parë në karrierën

e saj Seerna Williamsi nuk e kishte mbyllur ndeshjen vetëm me një "game" të fituar, ndërkohë që katër vjet më parë ishte mundur 2-0 (6-0, 6-2) nga Halep dhe 20 vjet më parë, po 2-0 (6-1, 6-1) nga Krueger. "Ishte një ditë e keqe, shumë e keqe. Konta luajti mjaft mirë, lëvizte në fushë dhe përfitoi më së miri nga loja ime pa nerv. Në setin e parë nuk isha aspak e përqendruar në fushë, ndërsa rivalja shtoi

besimin në forcat e saj. Ndoshta kjo mbetet ndeshja më e dobët e karrierës time. Sigurisht se mund të luaj më mirë se kaq, por shoh me optimizëm përpara, pasi kjo ishte ndeshja e parë pas Wimbledonit, ndaj do ta vazhdoj punën", ka thënë Serena Williams, që në këtë takim bëri 25 gabime, duke bërë që publiku të heshte nga kjo paraqitje zhgënjyese e idhullit të shtëpisë.

SHKURT

Interi "ëndërron" transferimin e Modriqit

Skuadra e Interit është "dashuruar" në futbollistët kroatë. Kjo skuadër, pas Perishqit dhe Brozovqit, ka transferuar mbrojtësin Vrsaljko, por kjo nuk është e tëra për faktin se drejtuesit e këtij klubi janë të interesuar edhe për Luka Modriqin. Pavarësisht prej interesimit të Interit, Real Madridi vështirë se do të heqë dorë nga mesfushori i saj, sepse pas largimit të Cristiano Ronaldos largimi eventual i Modriqit do të ishte një goditje e madhe për klubin.

Celina transferohet te Swansea

Swansea City ka kompletuar transferimin e sulmuesit shqiptar Bersant Celina nga Manchester City. 21-vjeçari ka nënshkruar kontratë katër-vjeçare dhe pritet të jetë i gatshëm për ndeshjen e Championshipit kundër Sheffield Unitedit.

Unitedi dënon Martialin

Manchester Unitedi e ka dënuar me 180 mijë paundë Anthony Martialin për shkak se ai e ka braktisur për më shumë se një javë skuadrën nga "Old Trafford". Martiali është larguar nga skuadra me arsyen se bashkëshortja e tij e solli në jetë fëmijën e parë. E ardhmja e futbollistit francez në skuadrën angleze duket e pasigurt, kurse shumë klube të mëdha evropiane janë të interesuara për transferimin e tij në këtë afat kalimtar.

Digne prezantohet te Evertoni

Mbrojtësi Lucas Digne ka kompletuar transferimin tek Evertoni nga Barcelona. Mbrojtësi i kraut të majtë ka nënshkruar kontratë pesëvjeçare me klubin anglez, i cili ka paguar 20 milionë funte. 25-vjeçari ka qenë pjesë e Paris Saint-Germain dhe Romës.

Balotelli kërkohet nga Dortmundi

Sulmuesi italian tashmë ka vendosur të mos vazhdojë me Nicen në Francë. Ish-anëtari i Interit e Milanit ka dështuar të arrijë një marrëveshje me Marseillen, ndërsa për të interesim ka pasur nga Torino dhe Parma në Serinë A. Por, në çastet e fundit është Borussia Dortmund që po shqyrton mundësinë e afrimit të tij. Lajmi është dhënë nga gazeta italiane "TuttoSport", që e sheh të realizueshëm këtë transferim.

Tetë lojtarë largohen nga Liverpooli

Tetë lojtarë pritet të largohen në këtë afat kalimtar nga skuadra e Liverpoolit. Danny Ings, Divock Origi, Simon Mingolet, Lazar Markoviq, Pedro Chirivella, Marko Grujiq, Sheyi Ojo dhe Ben Woodburn janë lojtarët që nuk bëjnë pjesë në planet e trajnerit Jurgen Klopp. Liverpooli në këtë afat kalimtar ka transferuar Xherdan Shaqirin, Alisson Becker, Keitan dhe Fabinhon.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova - Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA"
Prizren



Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit të 4 Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, aprovimit nga drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së të kërkesës nr. 2/93 të datës 03.05.2018 dhe nenit 13, paragrafi 1.1 të Statutit të Spitalit, Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm shpall:

KONKURS

Institucioni: Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. DAUT MUSTAFA" Prizren

Nr.	Mjekë Specialistë	Reparti	Kërkohen
1.	Mjekë Specialistë - Internist	Reparti i Sëmundjeve të Brendshme	1

Koeficienti i pagës: (8.4)
Norma e punës: Orar i plotë (40 orë në javë)
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Raporton: Shefit të Repartit Përkates
Nr. i Referencës: 8/19
Data e shpalljes: 01.08.2018

Qëllimi kryesor i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka Përgjegjësit kryesorë të mjekut specialist:

- Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, pajisjet, objektet e inventarin për nivelin të cilit i takon.
- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve.
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
- Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues.
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit.
- Kryen evidentimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletëshimi, protokollit etj) të pacientit.
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor.
- Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative,
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditore të punës të stafit punues.
- Jep mendime profesionale për punën që e kryen.
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.
- Kryen edhe detyra të veçanta kur i kërkohen lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që e ka.
- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës,
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës,
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnimi profesional,
- Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës).
- Siguron ambient të pastër e të sigurt për të gjithë,
- Menaxhon me material shpenzues dhe pajisjet tjera,
- Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit,
- Përpunon dhe realizon protokole profesionale të trajtimit të pacienteve,
- Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale,
- Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësisë profesionale dhe kolektiv në repart(njësi).
- Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj,
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor bazuar në nivelin profesional që ka,
- Dhënia e këshillave profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapisë ditore,
- Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve klinike-laboratorike,
- Sipas radhës punë në ambulancën për pacientët jashtëspitalor dhe nënë ekzaminimin-pranimin e tyre.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
- Licenca e Specialistit të lemisë përkatëse;
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnime të veçanta, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;
- Të ketë shkathësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Letërnjoftimi fotokopje ose leja e banimit të përkohshëm, dhe
- Certifikata e lindjes, fotokopje.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë, shtetas të Republikës së Kosovës, Mjekë specialist të lëmive përkatëse, që nuk janë punësuar në Institucionet Publike Shëndetësore.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kushtet e konkursit.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit. Nuk do të pranohen aplikacione ndryshe nga dëshmitë që kërkohen më këtë konkurs.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Drejtor i Administratës
MSc. i Juridikut Melinda Collaku



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova - Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA"
Prizren



Prema članu 8, tačka 1 i 2, Zakona o radu br. 03/L-212, člana 4, Administrativnog Uputstva (MRSZ) Br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, odobrenje od strane generalnog direktora SSHKUK (zahteva br. 2/93, dana 03.05.2018) i člana 13.stav 1.1 Statuta opšte bolnice, Upravni savet opšte bolnice raspisuje:

OGLAS

Institucije: Opšta Bolnica, "Prim. Dr. Daut Mustafa" Prizren

Nr.	Doktor specialista	Odeljenje	Trazeno:
1.	Doktor specialista - Internist	Odeljenje za unutrašnji bolesti	1

Koeficijent zarade: (8.40)
Radna Vreme: Puno radno vreme.
Ugovor: Prema važećim zakonima
Izveštaj: Šefu Odeljenja
Referentni br. 8/19
Datum objavljivanja: 01.08.2018

I. Osnovna svrha posla – za specialista:

Pružanje zdravstvenih usluga u pogledu kvaliteta i kvantiteta zasnovane na profesionalnom nivou koj je blisko.

